F. A. SANTORI

SATIRA

Përgatitur nga
Karmell Kandreva dhe
Gjovalin Shkurtaj

DITURIA

DEGLI STUDI
ALABRIA

OTECA
REA
STICA

Scanned with CamScanner

Scanned with CamScanner

Anton Santori

Satira

Françesk A. Santori mund të quhet si një nga fjalëkrijuesit më të zellshëm të letërsisë arbëreshe. Ai është autori që pikërisht në këtë lëm u dallua në mënyrë të qartë nga të gjithë shkrimtarët e tjerë bashkëkohës e pasardhës. Dhe kjo nuk qe një gjë gand dhe e rastit, apo një "ves" a mani e Santorit. Duket qartë se kemi të bëjmë me një nismë e veprimtari të qëllimshme të tij, me një sprovë të guximshme dhe qëllimlartë për pasurimin e shqipes me fjalë e terma të krijuara me brumin amtar, duke u mbyllur shtegun fjalëve të huaja e të panevojshme e sidomos bastardimit të arbërishtes nga ndërhyrja e italianizmave.

Gj. Shkurtaj

ISBN 99927 - 31 - 23 - 0

F. A. SANTORI

SATIRA

Përgatitur nga
Karmell Kandreva dhe
Gjovalin Shkurtaj

DITURIA

UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DELLA CALABRIA
ALB
SX
SAN
A
1
BIBLIOTECA DI AREA UMANISTICA

Scanned with CamScanner

u.s 184472

CIP - Katalogimi në botim - B. K. Tiranë
Santori, Françesk A.
Satirat / Françesk A. Santori;
Transliteruan dhe pajisur me shënime nga K.Kandreva, Gj.Shkurtaj.- T.: DITURIA, 1998
80 f.; 21 cm.
ISBN 99927 - 31 - 3 - 0
1. Satirat arbëreshe - Itali
891.983 (= 919.83: 450) - 7

Shtypur në Shtypshkronjën "TIRANA" Tiranë 1998

881
SAN
A
1

FRANÇESK A. SANTORI

B.A.U. "F.E. FAGIANI"
U0020624

SATIRA

Università degli Studi della Calabria - Biblioteca di Area Umanistica

Transliteruar dhe pajisur me shënime nga
Karmell Kandreva dhe Gjovalin Shkurtaj

Shtëpia Botuese DITURIA

Scanned with CamScanner

Françesk A. Santori
Satira

Transliteruar dhe pajisur me shënime nga
Karmell Kandreva dhe Gjovalin Shkurtaj

Kopertina:

© DITURIA, 1998

SATIRAT

Kërkimet arkivore dhe hulumtimet e shumta nga studiuesit arbëreshë F. Solano, K. Kandreva, K. Stamile, G. Gradilone, E. Toçi etj., si dhe të studiuesve tanë V. Bala, A. Varfi, K. Kodra etj., po tregojnë se F. A. Santorit, përveç veprave të tij të njohura, i përkasin edhe shumë dorëshkrime të tjera, të pabotuara, njohja e të cilave bën më të qartë se ai qe poet, dramaturg, romancier, fabulist, që i ka dhënë artit të fjalës më tepër nga ç'dihej deri vonë. Zbulimi i veprave të pabotuara të F. A. Santorit, si romani "Sofia Kominiate" e të tjera, si dhe njohja më e mirë e atyre që kanë qenë botuar por që nuk kanë pasur përhapje të gjerë, japin mundësi të shihet se ky autor kishte vlera më të mëdha se një tok shkrimtarësh të radhës së tij (Shih, V. Bala, "Vepra të pabotuara të F. A. Santorit", në "Drita", 21 dhjetor 1975, f. 12).

Një nga veprat e pabotuara të F. A. Santorit është edhe "Satirat", të cilën e zbuloi para pak kohësh poeti dhe studiuesi arbëresh K. Kandreva, në fshatin Shën- Japëk të Qanës (Çerzeto). Kur vizitoi Shqipërinë për herë të dytë, në verën e vitit 1979, Kandreva e solli me vete këtë dorëshkrim të çmuar dhe ia fali Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. (Noftimi i parë për gjetjen e veprës u dha në "Drita", 3 shkurt 1980). Megjithëse i vjetruar dhe i dëmtuar nga koha dhe mjedisi jo i përshtatshëm ku është gjetur, dorëshkrimi mund të thuhet se është i plotë. Bashkë me K. Kandrevën ia hymë punës për transliterimin dhe pajisjen me shënime të kësaj vepre.

*
* *

Dorëshkrimi është në një fletore të trashë, shkruar me penë, me një bukurshkrim (kaligrafi) shumë të kujdesshëm dhe me grafinë e zakonshme të veprave të Santorit.

Anët e dorëshkrimit, sidomos në pjesën e poshtme të faqeve të fundit, janë të dëmtuara shumë dhe ndonjë rresht nuk është e mundur të lexohet i tëri ose dhe mungon. Megjithatë, në tërësi dorëshkrimi është në gjendje të mirë, i lexueshëm dhe i kuptueshëm. Dorëshkrimi fillon në faqen 5. Ka humbur vetëm një fletë (faqe 3-4). Faqja e fundit ka numrin 142, por dorëshkrimi i gjithë ka më pak faqe, për arsye se "Satirat" në

Scanned with CamScanner

gjuhën shqipe janë shkruàr vetëm në faqet e parme (recto). Faqet e pasme (verso), autori i kishte caktuar për përkthimin në gjuhën italiane, punë të cilën e ka bërë deri në faqen me numër 13, pastaj e ka ndërprerë përkthimin, por faqet i ka lënë të bardha. Me sa duket ai kishte ndërmend ta kryente këtë punë, por nuk ka arritur.

*
* *

Dorëshkrimi është pa titull dhe pa ndonjë tregues tjetër që të dalë shprehimisht se i kujt është. Në kapakun e fletores është vetëm një vulë, e cila pas gjasësh do të jetë gjurmë e ndonjë prej punimeve të shumta që F. A. Santori bënte me porosi të njerëzve të ndryshëm për të fituar bukën e gojës. (Siç dihet Santori ka jetuar në kushte të rënda ekonomike, duke dhënë mësime në shkollën e fshatit dhe duke shitur objekte e vegla druri që i punonte vetë. Shih edhe "Historia e letërsisë shqipe", II, Tiranë, 1960, f. 12 dhe F. Salono, "Il canzoniere albanese", Quaderni di "Zjarri", 1975, f. 25).

Edhe pse mungojnë titulli dhe emri i autorit, ne jemi të bindur se kemi të bëjmë pikërisht me veprën "Satirat" e Françesk Anton Santorit. Për këtë na dëshmojnë: 1) Grafia dhe bukurshkrimi (kaligrafia) që janë të njëjta me veprat tjera të Santorit. 2) Vendi i gjetjes së dorëshkrimit në fshatin Shën - Japëk të Qanës (Çerzeto) në shtëpinë e Sarro Françesk Antonios, një të afërmi të famullitarit që ka punuar në Shën- Japëk si prift, pikërisht në atë vend ku pat punuar edhe Santori. 3) Prania e vjershës "Mjekërari". (Në tekstin "Historia e letërsisë shqipe", II, Tiranë 1960, f. 121 lidhur me "Satirat" thuhet: "Për fat të keq, vjershat satirike të tij mbetën pa u botuar dhe s'i njohim, me përjashtim të vjershës "Mjekërari". 4) Stili dhe gjuha e veprës "Satirat", të cilat kanë identitet të plotë me veprat e tjera të njohura të F. A. Santorit. Në radhë të parë, vlen të përmendet ajo që përbën një veçori të spikatur të shkrimeve të Santorit: leksiku i pasur me elemente fjalëformuese të brumit amtar, të natyrës popullore po jo të përdorimit të përgjithshëm si: *mjekërar, shërbejtar, rremëtar, ultare, punonjer, vjedhëtare* etj., të cilat janë aq të dendura edhe ne veprat e njohura të këtij autori.

Vepra përmban 31 pjesë të shkruara në vargje, në strofa gjashtëshe, çdonjëra prej të cilave mban edhe titullin përkatës:

E vobëka e ljigë "e vobekëta e mjerë", e përbërë nga 54 vargje (= 9 strofa);

Kopilja mashkullore "vajza mashkullore", me 12 vargje (= 2 strofa);

Gjitonia gjuhëgjatë "fqinja llafazane", me 48 rreshta (= 8 strofa);

Këpucari e qepëtari "këpucari e rrobaqepësi", me 30 rreshta (=5 strofa);

Punonjeri "punëtori", me 18 rreshta (= 3 strofa);

Gruaja pitare "gruaja pijanece", me 54 rreshta (= 9 strofa);

Trimi i lavur "djali i krisur", me 42 rreshta (= 7 strofa);

Kallonjeri "mashtruesi", me 24 rreshta (= 6 strofa);

Zarritasi "thërritësi, propaganduesi", me 127 rreshta (= 21 strofa);

Spiuneshat "spiunet", me 66 rreshta (= 11 strofa);

Pijëtari "pijaneci", me 36 rreshta (= 6 strofa);

Nxerrëtari "grindaveci", me 60 rreshta (= 10 strofa);

Vjedhëtarja e shtëpisë, me 48 rreshta (= 8 strofa);

Nëmëtarja "ajo që nam, që mallkon", me 24 rreshta (= 6 strofa);

Divotja e rreme "e devoçmja e rreme", me 54 rreshta (9 strofa);

Sbesullori mallëkonjëtar "ai që nuk beson e mallkon", me 56 rreshta;

Mjekërari "berberi", me 24 rreshta (= 4 strofa);

Rremëtari "gënjeshtari", me 36 rreshta (= 6 strofa);

Shërbesëtari "mëditësi, bujku mëditës", me 72 rreshta (= 12 strofa);

Mjeshtri drujtar "druvari", me 96 rreshta (= 16 strofa);

Hekurtari "ai që përpunon hekurin", me 60 rreshta (= 10 strofa);

Mushkëtarët "qiraxhinjtë, ata që mbartin me mushka" me 84 rreshta (= 16 strofa);

Vjedhëtarja pulashi "vjedhësja e pulave" me 36 rreshta (= 6 strofa);

Vashëza çotëz e gjitonia e shpejtë "vajza e marrë dhe fqinja e zgjuar", me 122 rreshta;

Kopilja "vajza, vasha", me 48 rreshta (= 8 strofa);

Këngëtorjesha e nuseve "këngëtorja e nuseve", me 48 rreshta (= 8 strofa);

Ëngjelit e nipërat "ungjët dhe nipat", me 125 rreshta;

Jatroi jatriser "mjeku farmacist", me 78 rreshta;

Vobëktari i mirë "vobekëti i mirë", me 170 rreshta;

Karroqari "kopraci", me 102 rreshta;

Vidhjuzia "zilia", me 31 rreshta.

Vepra me sa duket është e papërfunduar, ndonëse dorëshkrimi (fletorja) përfundon dhe nuk lë gjurmë që të tregojnë vijim. Sidoqoftë, kemi të bëjmë me një tufë satirash që arrijnë në 1845 vargje, me një tematikë të larmishme dhe mjaft interesante e të trajtuar me vetiakësi (origjinalitet) të dukshme.

Kjo përmbledhje vjershash satirike tregon se F. A. Santori kishte një diapazon të gjerë poetik. Ai është i pajisur me ndiesi të holla edhe në lëmin e humorit. Vargjet e tij satirike ngërthejnë, jo rrallë, nota të

Scanned with CamScanner

Scanned with CamScanner

forta ironike e sarkastike me anën e të cilave Santori godet një varg të metash dhe vesesh, si dhe ndonjë plagë me karakter shoqëror, si thashethemet ("Gjitonia gjuhëgjatë", "Nëmëtarja"), zilinë ("Nxerrëtari), vjedhjen e mashtrimin ("Kallonjeri", Vjedhëtarja pulashi", Vjedhëtarja e shtëpisë", Vashëza çotë e gjitonia e shpejtë", "Jatroi jastriser" etj.), hipokrizinë ("Divotja e rreme"), gënjeshtrën ("Rremëtari"). Me nota të forta satirat e Santorit godasin edhe një varg tipash të tjerë si të pandërgjegjshmit e hileqarët ("Shërbëtori", "Mjeshtri drujtar", "Punonjeri" etj.). Një vend të madh zënë në këtë vepër edhe satirat kundër pijanecëve, ose siç i quan ai "dejmarakëve" ("Gruaja pitare", "Trimi i llavur", "Pitari").

Por syrit dhe penës së Santorit edhe në satirat nuk i kanë shpëtuar edhe plagë më të të rënda me karakter shoqëror nga të cilat vuante së tepërmi rendi ekonomiko- shoqëror i kohës. Santorit i qan zemra për të varfërit, i dhimbsen dhe i vjen keq që ata vuajnë e shtypen, ndërsa një pjesë tjetër, të pasurit, hanë e pinë, ngrohen e u skuqet faqja nga të ngrënët, stolisen e qëndrojnë hijerëndë duke u mburrur me kamjen e tyre. Në këtë ndarje e kundërvënie të ashpër e të papajtueshme shoqërore. Në këtë ndarje e kundërvënie të ashpër e të papajtueshme shoqërore, Santori, pa asnjë mëdyshje, merr anën e të varfërve, anën e punëtorëve që janë të detyruar të rrojnë me lëmoshën e atyre që "nëng buftonjën lipisi" që nuk tregojnë mëshirë.

Nuk është aspak e rastit që përmbledhja me vjersha satirike e Santorit nis pikërisht me vjershën "Vobëka e ljigë", ku plot mëri, në kulmin e zemërimit e vobëka "e varfëra, e mjera" shfren në namë e mallkime të ashpra drejtuar atyre që tregohen zemërgur, të pangopur e të pandjeshëm ndaj të mjerëve:

Kush të veshurën ka t'artë
S'ndigon çë ndien ai
Çë per timt stafidhjoset
E nga uri pjasën e ljoset.

Vargje të tilla tregojnë qartë se zemërimi e mëria e vobëkës janë të ndjera e të përjetuara thellësisht nga vetë autori, F. Santori, i cili, siç dihet, jetoi dhe punoi në kushtet e një varfërie të madhe dhe vdiq në mjerim të plotë. Santori qe murg e pastaj prift, por kjo nuk e pengon aspak që të shfrejë me mëllef të fuqishëm ndaj padrejtësisë shoqërore dhe me ton paditës, akuzues ai thërret me gojën e vobëkës "të varfërës":

Ndë te qielli je ti Zot
Keq i drejtë setheos;
E gjëllin pamasë e mot,
Tash e njeh se bretkosë
U s'jam; moj jam e tërë
si të tjerët me ligjë e bërë".

Tema e mjerimit e ka shqetësuar se tepërmi Santorin, prandaj në këtë përmbledhje vjershash ai s'i ka kursyer vargjet për të nxjerrë në pah jo vetëm gjendjen e mjerë, por edhe vetitë e mira e virtytet e larta të shtresave të varfëra. Në mënyrë të qartë kjo duket te "Vobëktari i mirë", ku shohim se sa me simpati e ngrohtësi është përshkruar bota shpirtërore e "vobëktarit". Santori nxjerr para lexuesit një të varfër të virtytshëm, që nuk ka asnjë ves, që nuk pi, që nuk gënjen, që rron i përkortë e me dinjitet.

Në disa nga vjershat satirike, me ironi e sarkazëm të fortë Santori ngrihet kundër shtypjes së egër që i bëhej popullit nën maskën e mbulesën e fjalëve demagogjike. Nëpërmjet një forme shumë të qëlluar, në to tregohet se si shfrytëzohej e mbahej nën zgjedhë masa e gjerë e popullit nga rregji "mbreti", notari "noteri", rregjistrari "regjistruesi" etj., të cilët vinin taksa aq të rënda deri edhe për mullirin, ku "duan paguar ka një koqes çë është e þjuar"

Tërë sistemi administrativ shfrytëzues goditet rëndë nga satira e Santorit, i cili zbulon se korrupsioni dhe ryshfeti sundonin kudo:

"Ndose kini ndonjë shërbes
Se ta bëni me njeri
Çë rri largu, pa nteres
Mund i shkruani e anangasij:
Katër solde sa lëshoni
Vete karta tek të doni".

"Satirat", bashkë me doreshkrime të tjera të Santorit, tregojnë se ky autor, ndonëse nga talenti mbase nuk i arriti bashkëkohësit e tij më të shquar, pati meritën t'i jepte letërsisë sonë të Rilindjes vepra që përmbajnë një problematikë të re, me karakter shoqëror dhe të thellojë elementet e realizmit, duke krijuar edhe karaktere, të cilat shprehin thelbin e vet shoqëror. (K. Kodra, "Studime filologjike", 2, 1979, f. 125).

Santori trajtoi tema dhe motive të nxjerra ose nga historia e shqiptarëve, ose nga jeta politiko- shoqërore e arbëreshëve. Tek "Satirat"

Scanned with CamScanner

shohim që kjo hulli thellohet e mishërohet në përpjekjen e autorit për të dhënë një tablo më të gjerë të problemeve dhe të shqetësimeve të bashkëkohësve arbëreshë, për të hyrë më thellë në dramat dhe humorin e tyre jetësor dhe me një frymë kritike të fortë vë gishtin në disa plagë shoqërore, çka merr rëndësi për problematikën dhe qëndrimin ideor të veprës, në gji të krijimtarisë letrare të këtij autori dhe në kuadrin më të gjerë të letërsisë arbëreshe e përgjithësisht shqiptare të periudhës përkatëse. Studimi i kësaj ane i mbetet së ardhmes dhe shpresojmë se do të bëhet nga dijetarët specialistë, të cilët tashti do të kenë në dorë edhe këtë vepër të panjohur të F. A. Santorit.

Me këtë rast dua të përmend me mirënjohje e nderim të thellë, mukin tim të ndjerin Karmell Kandreva, studiues dhe poet i njohur arbëresh, i cili e zbuloi këtë vepër dhe e solli për botim në Shqipëri.*

Prof. Dr. Gj. Shkurtaj

* Për herë të parë "Satirat" u botuan në revisën "Studime filozofike", 1982. Nr. 2, f. 173-208. Më pas ato janë botuar edhe në Kosovë, nga Ramiz Kelmendi, por pa përmendur se ishte një ribotim krejt i njëjtë më atë të bërë prej nesh në "Studime filozofike". Gjëra që ndodhin (edhe pse nuk duhet të ndoshin) në mjediset shqiptare të ndara me kufij shtetëror e të tjerë.

E VOBÉKA E LIGÉ

Thoj ajo: ndose gjëllinj[1]
Kam sperancë[2] se dita e mirë
Sot o nesër ka të më vinjë
E më parë të des, një hirë[3]
Kam të e shoh edhe këtu
Të venë të tjerët posi u!

Lipinj bukë, e thonë se s'kanë:
Një liverez[4] nëng më japin.
Trokollonj[5], e se ngë janë
Bën e xë, të mos të më hapën.
Pjasinj timit[6], e njeri
Nëng bufton[7] për mua lipisi[8]!

Pishkalaqëra[9] kam t'i shoh
Ndë këto udha e prë ndë dier[10]
Duke lipur me një vohë[11]
Hejmëtare[12] , ndonjë lërier[13]:
Një tul bukë e njetër gjë
Çë të i lipset më e më.
Po të njohën si i thartë[14]
Është të lipurit, e si
Kush të veshurën ka t'artë
S'ndigon çë ndien ai

1) *gjëllinj:* jetoj
2) *sperancë:* (it.) shpresë;
3) *hir:* hir, mirësi;
4) *liverez:* rreckë, shami, arnë;
5) *trokullonj:* trokas, trokëllij;
6) *tim-i:* të ftohtë: bën tim "bën ftohtë"; dëgjohet edhe **tëtim** që na kujton thellim-i të të folmeve të jugut dhe **stym-i** p.sh. **ka dek stymit** "ka vdekur nga të ftohtit" të të folmeve të Malësisë së Madhe;
7) *bufton:* buthton, tregon, dëfton;
8) *lipisi:* (gr.) mëshirë, keqardhje;
9) *pishkalaq-e:* lakuriq, i zhveshur, zheshakaraq-e;
10) *prë ndë dier:* derë për derë, derë më derë;
11) *vohë-a:* vapë, ufmë, këtu: nevojë, hall;
12) *hejmëtare:* e helmuar; fjalë e re e formuar nga Santori mbi bazën e hejm < helm+ tar;
13) *lërier:* mys, të mbetura në tryezë pas të ngrënit;
14) i *thartë:* i hidhur;

Scanned with CamScanner

Çë për timt stafidhjoset[15]
E nga uri pjasën e ljoset[16]

Hanë e pinë, ngrohen e nguqen[17]
Po si marreza[18] je pjekur
Fjën si lirat[19] e ndërluqen[20]
Ndën pojaca[21], rrinë të qepur,
Mirë stolisen e buftojnë
Posa kanë e më mallkojnë

Fatin çë ngë i dha më shumë
Petka, argjënd, ar e turres[22]
Me bunënxje[23], si një lumë
Çë është i pjotë; po të ftesë[24]
Bënjinë më të rënda e më
Mos t'i japin vobëkut gjë:

Vafçin gjith si vete u
Prë ndë dier e më përzënë
Gjithë. Mos pafshin fare ku
Kriet e kurmin mund të vënë
Pjafshin[25] urit, e njeri
Mos i paftit lipisi.
Ndë te qielli je ti zot,
Keq[26] i drejtë setheos[27],
E gjëllin pa masë e mot
Tas[28] e njeh se bretokosë
U s'jam; moj[29] jam e tërë
Si të tjerët me ligjë e bërë

15) *stafidhjoset:* rrudhet, bëhet si stafidhe nga të ftohtit;
16) *ljoset:* shkrin;
17) *nguqen:* skuqen;
18) *marreza:* mare, koçimare;
19) *lir-i:* gjeri, gjerorja;
20) *ndërluqen:* shtruken, fshihen, mbulohen;
21) *pojacë-a:* mbulesa;
22) *turres:* para, të holla;
23) *bunënxje* (it.) bollëk, sasi e madhe;
24) *të ftesë:* faj, mëkat;
25) *pjafshin:* plasshin, pop.: plaçin;
26) *keq:* shumë, keq i drejtë "shumë i drejtë, fort i drejtë";
27) *setheos:* (gr.) se je perëndi;
28) *tas:* tash, tani;
29) *moj:* por; e dendur te Santori; nuk del te autorë të tjerë arbëreshë;

Gjegjëm andaj e gjitha ata
Çë s'kanë për mua gjë gjë.
Maj[30] s'pafshin[31] e ndër ta
Shtrëmbërisht[32] u rruafshin[33] më
Lig[34] se qentë, kur çë hanë
Ndë një koritë[35], e shumë s'kanë.

KOPILJA MASHKULLORE

Anaterezja, cila bëj
Bukureshën[36] e kushqit[37]
Mbaj për poçe[38] e zgjidh e lëj[39]
Një për njetër[40] , muari hit
Për pjëh ari[41]! U mbjak[42] e rrij[43]
Me të sajën virgjëri
Duk se thoj[44] se kallogrenë
Duaj[45] të bënej[46] ndë shtëpi.
Endërrij[47] shoqëra[48] e me pen[49]
Qaj të zbjerrën[50] bukuri.
Moj e zefka[51] prë sa bën
Më një shoqëth[52] nëng e gjën.

30) *maj:* (it.) kurrë: **maj s'pafshin** "kurrë mos paçin";
31) *pafshin:* paçin;
32) *shtrembërisht:* shtrembër, fjalë e re e krijuar nga Santori, nuk dimë të dalë në autorë të tjerë arbëreshë;
33) ruanj: shoh, shikoj: shtrembërisht u ruafshin "u pafshin shtrembër";
34) *lig*: keq; **më lig se qentë** "më keq se qentë"; është interesant të shihet që arbëreshët e përdorin edhe me kuptim ndajfoljor, ndërsa në të folmet e shqipes del vetëm me kuptim e trajtë mbiemrore: **lig-ë** (i, e);
35) *koritë-a:* enë druri ku u hidhet ushqimi derrave, qenit etj.;
36) *bëj bukureshën:* mbahej si bukuroshe, mbahej tepër krenare;
37) *kushqit:* krushqit;
38) *mbaj për poçe:* bënte për asgjë, nuk u jepte rëndësi;
39) *zgjidh e lëj:* zgjidhte e linte;
40) *njetër:* tjetër;
41) *muari hit për pjëh ari:* frz. mori hirin për pluhur ari, u gënjye;
42) *u mbajk:* u mplak;
43) *rrij:* rrinte;
44) *thoj:* thoshte;
45) *duaj:* donte;
46) *të bënej:* të bënte;
47) *ëndërrij:* ëndërronte;
48) *shoqëra:* shokë, shumësi i shoq;
49) *me pen:* me vuajtje, dhembje;
50) *të zbjerrën:* të bjerrën, të humburën;
51) *e zefka:* e zeza, e mjera;
52) *shoqëth:* shok, burrë;

Scanned with CamScanner

GJITONIA GJUHËGJATË

Nikolina me sa kish
Burra e gra ndë gjitoni[53]
Semre[54] zëhej e se ngë ish
Thoj si ajo mbi dhe njeri:
Moj pëstana[55] kur spovisi[56]
Edhe pula më e cimbisi[57]
Patëtin gust[58] se me shëndet
Vate gjuha gjatullore[59]
Cila mosnjeriu[60] ndë jetë
Lënej nder o hje ampënore[61]
Moj i shaj e i përshaj
E nga mizat bëj një maj[62]
Thoj: të shtrembur ka kjo
Hundën e gojën e mbënjanë
Dja si gërthja[63] vete ajo.
Gjithë të shëmtuar më janë,
Njerzit te kjo gjitoni
E nkë sheh të drejtë njeri.
Si u lenë? Ç'vjen me thënë
Ki shërbes?[64] Ngë vren me çerë[65]
Një të bukur; si të bënë
Qenë me topër[66]; e si skalier[67]
Duken të ashpër më se janë
E po ka kondra[68] e vixe[69] kanë

53) *gjitoni-a:* fqinjë;
54) *semre:* (it.) gjithmonë;
55) *pëstana:* pastaj;
56) *spovisi:* (gr.) ngordhi, cofi;
57) *cimbisi:* pickoi, çukiti;
58) *patëtin gust:* patën shije, patën ëndje;
59) *gjatullore:* fjalë e re, e krijuar nga vetë Santori;
60) *mosnjeri:* asnjeri, askush;
61) *hje ampënore:* hje të qetë, paqe;
62) *nga mizat bëj një maj:* "nga mizat bënte një mal"; frz. bënte qimen tra;
63) *gërthja:* ngërthje;
64) *sherbes-i:* punë, çështje;
65) *çerë-a:* çehre, pamje, fytyrë;
66) *tóper:* sëpatë;

Kush me gúaljar[70] e me vocë[71]
Kush me koshin[72] e më i brutë[73]
Është si ursi[74] ; e si një stoc[75]
Druri duket. Si kukut[76]
Faqen kanë të verdhë të tjerë
E të shtipur e të gjerë.

Mjera u! Ndë mes të këtire
Kam gjëllinj, posi një lule
Prë ndë gjëmba, e nikoqire[77]
Jam ndë bajta[78]; e si kukule[79]
Prë ndë ferra; çë me vlen
Bukuria çë më shkëlqen?

Duke thënë ashtu me gjithë
Gjithë i lodhi e m'i varresi[80]
Si ndë çerë edhe ndë vith[81]
Thojin posi vej shërbesi:
E si ajo së lej njeri·
Gjithë e zëjin pa lipisi.

Nunk u mbjak se diq e re;
E të madhe një ndonatë[82]
Brutullore[83] la mbi dhe
Sepse pati gjuhën e gjatë.
Ni ku zëhen gra me gra
Nikolina pjesën e ka.

70) *gualjar:* i shamtë, që i del zorra e barkut;
71) *vocë:* sëmungje e gushës që zë gratë;
72) *koshi:* xhungë në shpinë që kanë kurrizot;
73) *i brutë:* (it.) i keq;
74) *ursi:* (it.) ariu;
75) *stoc druri:* copë druri;
76) *kukut:* kuskutë;
77) *nikoqire:* amvisë;
78) *bajta:* balta;
79) *kukule:* fshikëza e krimbit të mëndafshit;
80) *varresi:* mërzitje;
81) *çë ndë çerë edhe ndë vith:* nga para e nga prapa;
82) *ndonatë:* (it.): nam, emër, jehonë;
83) *bratullore:* e keqe, formim i Santorit nga e brutë+ llore, ashtu si gjatullore nga e gjatë etj.;

Scanned with CamScanner

KËPUCARI E QEPËTARI[84]

Gjan Frangjisku bëj këpuc
E i qepij ngushtullore[85]
Aq, sa teku nxëj një vucë[86]
Hij një bute[87] madhullore[88].
E ngolisur[89] si mund rrij
Sholla? E ditën e jetër bij.[90]

Sod të taksij[91] se të i bëj;
Pas di javë ashtu të thoj:
I mërritur[92] maj të lëj.
Qelij dhunë[93] ashtu e dërgoj
Një shërbeme[94] ka një ditë
Të ish e bënur në njetër vit.
Anangasej[95] më se bleta
Prë ndë lule Zepereli
Kur çë qepij, e vërteta
Ishin bathë, jo koqemeli[96]
Pundët[97] çë të bëj, e pra
Shqepëshin më se petku ata.
Mund e ruanje me sasi
Ka pagoj[98] te gjeri bisht
Se një arnarjel[99] të ri
Dij t'e shehij[100] ndë një gjisht

84) *qepëtari:* rrobaqepësi;
85) *ngushtullore:* të ngushta;
86) *vucë-a:* vozgë, enë e vogël për të mbajtur pijen;
87) *bute:* but-i;
88) *madhullore:* shumë e madhe; fjalë e re e krijuar nga Santori, khs. gjatullore, brutullore, etj.;
89) *e ngolisur:* e lidhur, e bashkëngjitur;
90) *bij:* binte;
91) *taksij:* premtonte;
92) *i mërritur:* i meruar, i shqetësuar;
93) *qelij dhunë:* mashtronte;
94) *shërbeme:* punë, shërbim;
95) *anangasej:* nxitonte;
96) *koqemeli:* misër;
97) *pundet:* gojzë, vrimë e gjilpërës në stof etj. gjatë qepjes;
98) *pagoj:* palloi, pavoda;
99) *arnarjel-i:* arnë e vogël;
100) *shehij:* fshihte;

E kur pritij frëng frëng
Ndë një xhaket vidhij një mëngë
Taksij se të vij ndë dit
Neser, e pra së gjendej më
Ndë katund, kuazi[101] një vit;
E mbi gjithë ndë i jipnje gjë
Prë paguame[102], ahierna ndaj
Shehej mos t'e gjenje maj.

PUNÓNJERI[103]

Zepereli kish prë mjet
Një liksht pend qe:
Ndë të mbjella shkonej vet
Mbë vilaqe[104] ai mbi dhe
Se di pendë ngë bëjin: maj
Ndato ara drapëroj[105]
S'kish të trembej se dërsij
O se panka[106] prë ndë këmbë
Më e lart mund i vij.
Horovola[107] ndë pullëmb
Mëngu dukej, e i zoti
Thoj se kish ftesur[108] moti.
Paparun![109] Ftesi ai
Çë ngë i bëri argomën[110] thellë
E për një i qellij di
Gjavlaqe[111] greel[112], greel
Dheun i shprish[113] me parmënd
E si çot[114] e la kutjend[115]

101) *kuazi:* (it.) pothuajse, gati;
102) *paguame:* pagesë;
103) *punónjeri:* bujku, ai që punon me qe;
104) *vilaqe:* vende të ndryshme;
105) *drapëroj:* korr me drapër;
106) *panka:* plisi i dheut, busi;
107) *horovola:* dorëz gruri, duaj;
108) *kish ftesur:* kish faj;
109) *paparun-i:* qullaq, dembel;
110) *argomë-a:* hulli, brazdë;
111) *gjavlaqe:* ?
112) *greel- greel:* hollë- hollë, me delikatesë;
113) *shprishi:* shpërndau;
114) *çot:* i marrë, i krisur;
115) *kutiend:* (it.): i kënaqur;

Scanned with CamScanner

GRUAJA PITARE[116]

Haj si derrk[117] e pij si ka
Ndënjë katund një kalogre[118]
Të bëgatë[119], cilën e la
Zonjë i shoqi, e grua të re;
Ndo mpero[120] së martohej
E me njeter nëng shoqohej[121]

Ajo mbeti pa u martuar;
E çë bëri mos të shkoj
Gjellën e gjatë pa u helmuar?
Dimbëdhjet bute mbjoi[122]
Musht të zgjedhur, se ngamuaj
Një për vetëhenë[123] e duaj.

Bëj divoten[124] e ndë qishë
Gjegjij meshën nga menatë[125]
Ndë të veshurat ngë kish
Gjë të bardhë. Moj karitat[126]
Së kish prë ndonjeri, e mirë
Derën e shpisë mbanej e mbëllirë[127]

Buk e djath e hiromerë[128]
Haj e pij, e fjëj dhjet orë
Natën, e ditën di o tri herë
Vej ndë shtrat; e një kurorë
Patërnostrash[129] mbaj ndë duar
Po me gjithë se rrij qëlluar[130]

116) *pitare:* pijanece, që pi shumë alkool;
117) *derrk-u:* derr;
118) *kalogre-ja:* grua e ve;
119) *e bëgatë:* e pasur;
120) *mpero:* (it.) por, mirëpo;
121) *shoqohej:* shoqërohej;
122) *mbjoi:* mbushi;
123) *vetëhenë:* veten;
124) *bëj divoten:* frz. mbahej si e devotshme;
125) *ngamenatë:* çdo mëngjes;
126) *karitat:* (it.) mëshirë, lëmoshë;
127) *mbëllirë:* mbyllur;
128) *hiromerë:* proshutë;
129) *kurorë patërnostrash:* ...

Ndë katoq[131] vate një ditë
Se të shih veronjëzat[132]
Mos të rridhëjin, e ju shqit
Dreq nga zemra malli i gjatë
Se të njihij posi dij
Te kalmoreza[133] ndo pij.

Zgjodhi buten më të mirë
E ndë kalmore u picikar[134]
Mo dëthir,[135] tuke dëthir
Keq u deh, e u stunuar[136]
Aq, sa së diti të mbullij
Se pse shtuara[137] së mund të rrij.

Ra për trualli e vera i veej
Gjithë ndë faqe e murga[138] thoj
Butes më të mos lireej
Se sa piu sosi e shkoi
Shënjen edhe; moj shurdhullore
Butja shtij pa thënur jore.[139]

Pra nga vera kuazi e mbitur
U qendrua pa bënur gjë.
Vej me dorë verën tue shëtitur
Si të thoj: jo më? jo më?!
Butja u derdh, e kur rankoi[140]
Poshtë e mbesa lucën[141] çoi
Sheh çë bënjën gratë që pi në,
Se më zi se burrat janë!
Plasin, djegin e shtëpinë
E gremisjën, e ndo kanë
Petka shumë i bënjën pak
Mbjatu, o fare, si ajo pjak.

131) *katoq-i:* ahur, katua;
132) *veronjëz-a:* vëra, çepi i fuçisë;
133) *kalmoreza:* vendi nga del vera e fuçisë a e butit;
134) *u picikar:* u vu të thithë, u fut, u rras;
135) *dëthir:* thithur;
136) *u stunar:* (it.) humbi vetëdijen;
137) *shtuara:* më këmbë;
138) *murga:* e mjera, e nemura;
139) *jore:* jo, mohim;
140) *rankoi:* zbriti;
141) *lucë-a:* baltë, llucë;

Scanned with CamScanner

TRIMI I LAVUR

Ndë se dijit se çë bëri
Fulliberti, qeshjit gjithë
Me gërshërë tirqit i tëri[142]
E u vu ngaluar[143] ndë vith
Të një gadhuri,[144] cili u shtu
Drejt tek vendi tek u vu.
Kriengulaz[145] vate ra
E, mender atë buftoi
Çë nganjë mbuluar e ka;
E si një majal[146] qendroi
E fishkëllejin gjith, e rrij
Barkalartas[147] si një kunij.[148]

Pa një cop u ngre e vate
Tue grazuar[149] si kucamitë[150]
Pak u dhemb ajo shkopate[151]
Gazeshi çë pati; e prite
Se të nguqet; sikur maj
Kishim thënë atij; andaj
Hiri ndë një katoq e piu
Verë sa mundi e derdhi trut
Zu të lozij prana i ziu
moj s'i njih gurët e drut;
Kushdo deshi ahierna e mundi
E kushelt[152] mir ja shkundi.

Dual atena e tue mallkuar
Se ndigoi se buari shumë

142) *tëri:* preu;
143) *ngaluar:* kaluar, hipur mbi kafshë ose kaliboç;
144) *gadhuri:* gomari;
145) *kriengulaz:* me kokë poshtë, e krahasueshme me kryengul/ kryekul të të folmeve të Malësisë së Madhe;
146) *majal:* (it.) derr.
147) *barkalartas:* me bark përpjetë;
148) *kunij:* (it.) lepur i butë;
149) *tue grazuar:* duke kërcyer;
150) *kacamite:* dreni, drenusha;
151) *shkopate:* goditje me shkop;
152) *kushelt:* xhepat;

Si i lavur[153] udhën muar
Se të veej të fjëj ndë lumë
Te kështenjat kur arru[154]
Rrukulisi si një dru

Vej aposhtaz si një thes
Pjot, e bënej: pufti pu![155]
Gjëmbat nëng i patëtin bes
E e shquartin mbaru ashtu
Si lëvere çë qe vjerrë
Ndë një murriz, për t'ish e shqerrë.

Ati e ëma je kërkuan
Prë një dit e prë një nat
Tek e treta prana e çuan[156]
Gjithë të shqerrur e shangatë[157]
Gjims i dekur, ndë një përrua
Pa nji gisht e pa një thua.

KALLÓNJERI

Ai Dhuminku vate hiri
Ndë nji shtëpi te vidhij mbrolja[158]
Kur u pruar[159], i sfanëmiri[160]
Fijën e gjeti e bërë si Llolja[161]
Ndo se i pari jep ndë mest
E merr gjith sa janë turrest.

Qau se i bëtin një karicë[162]
Keq të rëndë se i paruan[163]
Eshtrat me një shat me pizë[164]

153) *i lavur:* i lënë trush, i krisur;
154) *arru:* arriti;
155) *pufti pu!:* pasthirmë imitative me bazë onomatopeike;
156) *çuan:* gjetën;
157) *shangatë:* topall, çalaman;
158) *mbrolja:* rroba, tesha, ndërresa;
159) *u pruar:* u kthye;
160) *i sfanëmiri:* fatkeqi;
161) *Llolja:* duhet të jetë ndonjë emër njeriu me që është shkruar me shkronjë të madhe
162) *karicë:* (it.) përkëdhelje, ledhatim;
163) *paruan:* i ranë me shkop, ia ndreqën kockat;
164) *pizë:* i rëndë;

Scanned with CamScanner

E kështu pra e dërguan;
Tuke thënur: se kush vjedh
Pjesët e mira nëng i zgjedh

Bjerrafati pat të duroj
Sa i pësoi, e të rrij qet!
Moj të nxirij brin penzoi[165]
Pas ca muaj e pas ca vjet;
Nëng i arruri[166] dreq shurbesi,
Se disinji[167] u shquar te mesi.

Vate, i çoti me ca të tjerë
Ç'ishin më se ai vjedhtar
Të kallojë[168]; e ata bujerë
Deshtin pjesën me të parë.
Vuri ai di u çë[169] mbënjanë
Mori ata për nxërr[170] e vranë.

ZARRITASI[171]

Ai demokrati çë kish
Gjuhën e gjatë sa një shpatë,
E je zëjë me kë do t'ish
Flitij semre, dit e nat
Murmurisij, shaj, turpëroj
Kudo rrij e kudo shkoj
Ish i njohur në katund
Më se një ndë nëmërat[172]
Nga sa di rrëvoj ndë fund:
Ish i vet e bëj për shtat.
Trëmëçin njerëzit më atij
Se ndë dekja ngrah i vij.

165) *penzoi:* (it.) mendoi;
166) *arruri:* arriti;
167) *disinji:* vizatimi;
168) *të kallojë:* të vjedhë;
169) *di u çë:* kushedi çfarë;
170) *nxërr:* grindje, zënkë;
171) *zarritasi:* thërritësi, ai që bën propagandë;

U mbushtua[173] një dit ndë agor[174]
E u vu të batalisij[175]
E të bëj shenja me ljor[176]
Se më dhezej e sërritij
Së ndëgojin seç' thoj
Po më gjind prë nën i arrvoj.[177]
Kur u mbjodhtin aq sa pak
Kin qendruar prë ndë katund
Veçse groçit[178] e ndonjë pjak
Me fuqi të madhe u tund
Zgurdulloi grikën e sit
Ruajti rreth rreth e zu të thoj
Sa ka një mund e ndigoj:

Lumt ju! nani s'kini
Lipse[179] më nga ndonjeri
Mund lodroni, hani e pini
Po si burr ç'i dejtur rrij
Çë ndë menat njera ndë mbrëma
Si dial ngjeshur nga e jëma.

Zoti rregj[180] e kamarat[181]
Më së miri u dreqëtin
Jo me një, e pes e shtat
Lidhëza ju lidhëtin
Aq sa më njeri së ka
Ënd të ngrëhet ka ku ra.
një duani vetëm nani
Kin të mbani ju ndë tru
Të paguani, mos ai
Të ju vërë me bith ndë hu
Posi turqit u zakuan[182]
Se të bëjin kuji së paguan

173) *u mbushtua:* u shfaq, u duk, (< u buftua < u buthtua)
174) *agor:* (gr.) shesh, qytet; horë;
175) *u vu të batalisij:* u vu të luftonte;
176) *me ljor:* me krahë;
177) *arrvoi:* arriti, mbërriti;
178) *groçit:* ata që nuk ecin dot, të lënë nga këmbët;
179) *lipse:* nevojë;
180) *regj-i:* (it.) mbret;
181) *kamarat:* (it.) degë të parlamentit të kohës;
182) *u zakuan:* u mësuan, u familjarizuan;

Scanned with CamScanner

Dheun ju lan të ja shërbeni
Pemat prana i mbjellën ata.
Se të shitëni e të bjeni
Lefterin[183] lexhja ju dha
Vet një pjes ju merr notari[184]
Kartat njetër; e regjistrari[185]
Merr didhjetme[186]. Trëmbësinë[187]
Më së kini të ju bënjin
Te kasizat[188] ndonjë terbim
Njer çë artikulin ngë gjenjin
Avukatrat ndë lexh
Cila ndreqet si një sexh[189].

Ndose lehij, nje ju shkruanjin
Ndë ca livra, se të dinë
Kur martohi, të kërkonjin
Pjesën e tire. E prë mullinë
Çë ju bënjin? Duan paguar
Ka një koqez çë është e bjuar.
Ndose kini ndonjë shërbes
Se të bëni me njeri
Çë rri largu, pa nteres
Mund i shkruani e anangasij!
Katër solde[190] sa lëshoni
Vete karta tek të doni!

Është vërtet se sadoherë
Udhën e bjerr e nëng rrëvon
Ku përlusni[191] ju të verë
Se ndënjë je hapën e ruan
Moj këtu stesën[192] njeri?
Kanë të bënjën lefteri.

183) *lefterin:* (gr.) lirinë;
184) *notari:* (it.) noteri;
185) *regjistrari:* regjistruesi;
186) *didhjetme:* dy dhjetëshe ose dy të dhjetat;
187) *trëmbësim:* frikë;
188) *kasizat:* (it.) degë të gjyqit të kohës;
189) *sexh:* ndenjëse karrigeje;
190) *solde:* (it.) të holla, para;
191) *përlusni:* dëshironi, lutni;
192) *stesën:* ka faj, fajëson; (khs, **ftesën** që përdor Santori në rase të tjera);

Tue shërbier ndo gadhnjeni
Ndonjë gjë gjë si të bugetë
Pjesën e kurthjes[193] kit lireni
E je vetma pjes ju nget
Ndo ka të ju jap njeri
Duan të e xënë me haptasi[194].

Ndose kin të jipni ju
S'duan të dinë, e ng' i mporton[195]
Fare fare, presën ashtu
Të vëdisni e prana thonë
Si gjiri të mirë çë qenë
Po se pjesi atire u vjen
Nga sa lëni e nje ju duan
Je mbë petka; moj kërkonjin
Vetëm ërgjënd e kuj s'paguan
Ndë ca mot ia shumësonjën
Di o tri herë; e mos nge gjënjin
Ndien sekuestrin[196] e pra lexhin.

Ajo shet pa të kërkon
Judhikon[197] e judhikime[198]
Moj çë bënj se ju kujtonj
Ca shërbise çë lingime[199]
Bën e ndien keq të thella
Sa për nxërr ju thahet gjella[200]

Ndo mos jetër, kripën vetë
Kish t'e jipëjin më të lirë
Se kur një gjendej i shkretë
E pa fare gjë të mirë
Më mbi dhe si një sardeje[201]

193) *kurthjes:* oborrit, i gjyqit;
194) *me haptasi:* me sy hapët, me kujdes, me interesim;
195) *ng' i mporton:* (it.) nuk ka rëndësi, s'i hyn në sy.
196) *sekuestrin:* (it.) sekuestrimin;
197) *judhikon:* gjykim;
198) *judhikime:* gjykime;
199) *lingime:* lëngime, brengë;
200) *gjellë-a:* jeta;
201) *sardeje:* sardele;

Scanned with CamScanner

Mund kriposej ndë tineje[202]
E të mënoj ndonjetër ditë
Pa u grisur, të kërkonjin
Të vdekur pas një vit
Vën te varri: ahierna çojin
Një paguame[203] keq të re
Çë vërtet ngë u pa mbi dhe!

Ni së kan ku marrën më:
Qishat e kumunet gjithë
Tas i xheshëtin, ndo kin gjë
Çë në cerk njera ndë vith
Këdo kish mir e qëruan
E stomaqin nëng e mbjuan

E të uripst[204] e djegur úrit
Më buftohen e s'kanë turp
Të lipinjinë molla gurit!
Dogjëtin gjith, po kudo nganë
E Italjen si shigjetë
Bën të mbrazëtë e të shkretë!...

U përgjigj një pjak e i tha
Ti kuraj[205] së fole dreq
Moj tue bënë nani këta
The vërtetën keq e keq!
Moj ndë i gjegj nga ata njeri,
Nji të vej në filiaqi.[206]

SPIUNESHAT

Papo papo! Giuzepina
Hëngri lakra e nëng u xu
E vindarti[207] Paskalina,

202) *tineje:* ?
203) *pagueme:* taksë, pagesë;
204) *të uripst:* të uritur;
205) *kuraj:* kurrë;
206) *filaqi:* burg;
207) *vindarti:* (it.) e pa, e shikoi;

Njize[208] bëndin[209] vate shtu,
E bumblloi[210] prë ndë katund
Çë ndë krie njera ndë fund.

Zun të flitjin e të thojin:
Kush e di ç'lakra qenë?
Cado tjerët më e zgjërojin
Tuke ruar shrëmbër shërbenin,
Njëra pra çë di u ç'thanë
E mbi derë mungën e nganë!

Karrubina çë vandohej[211]
Se sa bëhej nga shtëpi
Vet asaj nëng i mbulohej
Tha se hëngri ca nguli[212]
E ca rrapa[213] disa pite
Me ca sarda sapurite[214]

Bëtëtin rroqe[215], e nje Tereza
U përgjigj: si njoh këtu
Jini gjith me tru të leza[216]
Dreq shërbesin e di u
Po si vate e po si erdhi
E llanxheljen[217] kush ia deshi!
Vej e zeshka[218] se të gjej
Ndonjë rrësheje[219] e parpalidhe[220]
E njeri po dëm së bëj.
Moj ca njerëz çë me cimbidhe[221]

208) *njize:* herët;
209) *bëndin:* tellallin;
210) *bublloi:* trumpetoi;
211) *vandohej:* mbahej me të madh;
212) *nguli:* koçan lakre;
213) *rrapa:* një lloj bari, (it.) rapa;
214) *sarda sapurite:* sardele me shumë kripë;
215) *bëtëtin rroqe:* u bënë grup;
216) *të leza:* të lëna;
217) *llanxhelien:* shtëmbën;
218) *e zeshka:* e zeza;
219) *rrësheje:* lëpjeta;
220) *parpalidhe:* lëpjeta, trakalidhe
221) *me cimbidhe:* me kapëse, me mbërthejcë;

Scanned with CamScanner

Venë tue gjenë qimen ndë ve,
Së manguan kurráj mbi dhe!

E çë i bëtëtin! Margarita
Piejti; e Terezja: kush e di?
Thanë se Kaku Malavita
Ngrah ju hodh me mall të zi.
Burr i lig! Çë duaj nga ajo
Njo tani çë pien kjo.

Mua më thuaj çë duaj e deshi?
Ec e piej për vetëhenë?!
Margarita ahierna qeshi
E i thoj: kush të ndëljen[222]
The se dinje e së di gjë
Rremtare[223] sa jo më.

Gjith sa iu lëshuan një gaz
E Terezja u humb e u nguq
Moj nga turpja kur u mbraz[224]
Duaj të hap njetër sunduq
E të thoj di u sa shërbise
Të pësuara ndate vise

Sa një pjakë u bë përpara
E po thoj: çë janë këto
Fjalë të liga me të shara
Çë m'i jipëni? Ndose ajo
Juve thoji, sa thoni ju
Ju pëlqej nani këtu
Mbëllini grikën! Çë të e bëni
Ndose hëngtin o gjë jeter
Bëtëtin njerëzit; sa më xëni
Më pa nder buftohi, e njeter
Juve thotë ndë krah edhe
Se ju bëtë këtu e këtje!
Fjet me ligj, përgjegji Roza

222) *ndëljen:* fal, ndjen;
223) *rremtare:* gënjeshtare;
224) *u mbraz:* u çlirua, u lirua;

Pjak je mirë, çë arrvoj ahiera
E ngarkuar me ca skorca[225]
Gjith u nturpëtin e atena
Vanë nganjë te saja shpi,
Ca me paq, ca me nodhi[226].

Pijétari[227]

Aq ka vera çë dëthiti[228]
Gjikarjeli u bë si derk:
Katër herë truallin lëpiti
E u ngji[229] njera në cerk[230]
Ra për një të bënej di
Vate piu te kroi ati

Kur me uj verën përziejti
Nje stomaqi iu tërbua:
Sa se i tundej murgu ndiejti
Zu të villij si një krua;
E sa gjind shkojin atej
Gjith e ruajin se po vej

Tuke ratur[231], e së dij
Çë të bëj e çë të thoj.
Ndë një suport[232] u ngul të rrij,
Tuke mbarë dorën ndë gojë
Moj serpos[233] atje mënoi[234]
Aq sa gjumi më e qëlloi.

Kur u zgjua kushejt[235] i ngau;
Moj ca solde nëng i gjeti.

225) *skorca:* lëkurë lisi;
226) *nodhi:* (it.) urrejtje (< odio);
227) *pijëtari:* pijaneci;
228) *dëthiti:* thithi;
229) *u ngji:* u ngi, u ngop;
230) *cerk:* zverk;
231) *tuke ratur:* duke rënë;
232) *suport:* qoshk shameshin;
233) *serpos:* muzgu;
234) *mënoi:* mbeti;
235) *kushejt:* xhepat;

Scanned with CamScanner

Zu të nëmij si Kalau[236]:
E çë bëri ahierna i shkreti?
U shtëlua[237] prë ndë katund
Se t'i lipij njerzve kund.[238]

Gjithë e qeshëtin, e përqeshëtin
Dhia[239] si derku meritoi
Çotëra[240] qenë çë nuk të xheshëtin
Ka njeri çë e piqij thoj.
Moj përligu si u adhet[241]
Diq i dejtur e i shkret

Ati e jëma e kishin lënur
Mir të ndrequr e të begatë
Moj ai kështu tue bënur
Shumë te gjella nëng u ngjat.
Trim spovisi e posa kish
Gjith për ver të shitur ish.

NXËRRËTARI[242]

Pantaljeshi[243] mbi gjershi
Gjeti Engjëllën që haj:
Zu të pritij me diri[243/1]
Ajo murga thirr e qaj
Mbë sërpos u shtu e shtëloi
E gjershia? E prerë qendroi

E galufi[244] Pantaljesh
Ruanej dëmin e po rrij
I qanduar[245] atje si presh.
Parë të motërën çë vij

236) *Kalan:* emër i një personi që njihej si i tillë që mallkonte;
237) *u shtelua:* u nis;
238) *lip kund:* kërkoj llogari nga (it.) conto;
239) *dhia:* ja ashtu;
240) *çotëra:* të çmendur, të krisur;
241) *u a dhet:* u lig shumë;
242) *nxërrëtari:* ai që ngrindet për asgjë, grindaveci;
243) *Pantaljeshi:* emër me kuptim përbuzës;
243/1) *me diri:* me grindje;
244) *galufi:* i krisur, i çmendur;
245) *i qanduar:* i ngulur, i mbjellë;

Prap një tupi[246] vate u sheh
Si njeriu çë turpën njeh,

Kur gjershin gjeti të prerë
Zuri e motra të dërgojë
Nëmë si breshër. Këtë verë
Mos e shkofshtit dirrmë[247] thoj.
E je preçin posi preu
Këtë gjershi e je lireu.

Kish tri tumen[248] pema, e nani
Nëng vlen për mosnjeri!
Sod e parë çë bënj ati
Kur të vinj, e kur të rri?
Ku kam laginj grikën më
Kur së kam ndonjetetër gjë?

Njota pemët sikur qanjin
Gjithë të veshkur e njëmend
Qe je prerë. Ah, për Shën Janjin
Se të qendronja u kutjend[249]
Doj të keshja gjetur kur
Rrij të e prit aj gadhur!

Kushdo qe, qoftit i vrarë
E ja qellçin copa-copa
Ndë një duak[250], si savuçar[251]
Bënjin kur gramisën[252] lopa
O si mishtë kau i pjak
Qent e hëngërçin ndë një lak.

Pandaljeshit ra ndë tru
Ato nëmë të zjarrullore[253],
E rrëmbier atje një hu

246) *tupi:* vend me bar të lartë e kaçube;
247) *dirrëme:* grindje;
248) *tumen:* masë peshe, afërsisht 50 kg.;
249) *kutjend:* i kënaqur;
250) *duak:* duq, hejbe;
251) *savuçar:* kasap;
252) *gremisën:* thyen qafën, gremiset;
253) *zjarrullore:* të zjarrta;

Università degli Studi della Calabria - Area Umanistica - Biblioteca

Scanned with CamScanner

Aq të qellëjën ndë kurtë[274/1]
Prë këtë u qell e urtë.

Vetë e ngrohtën sadoherë
Me të rrahura të tharta:
Qenë për ta si shiu në verë
Çë u duthitën[275]. Ndë vende larta
Nëng rrëvoj të mirrij gjë
Se njeriu çë ka së fjë.

Diq e mjera ndë një katoq
Ngrën nga morrat e nga të tjera
Lipse rënda, e nëng u poq
Moj u dogj si frungulera[276]
Gjithnjëherje; e si gjëlliti
Lig, ashtu gjellën mbuliti[277].

Némétarja

Marjanela kish një dosë
Çë së e lëj një rrug të vej
Prë ndë katund. Një her u stros[278]
Mbi një djalë, të më i rrëmbej
Copën buk çë kish ndë duar,
E të di murgut ia shquar.
Dosën e vran, e ndë shtëpi
Më të murgës nëng ju pruar:
Zu të qanej me hidhi[279]
Tuke nëmur e mallkuar
Dual te dera, e prë tri dit
Gjak thërriti e mënit[280].

O çë pafshin aq pojata[281]

274/1) *qelei ndë kurte:* shpie në gjyq;
275) *u duthitën:* u thithën;
276) *frungulera:* pisha;
277) *mbuliti:* mbylli;
278) *u stros:* u sul;
279) *me hidhi:* me hidhërim;
280) *mënit:* hakmarrje;
281) *pojata:* plumbat;

Posa qime dosa kish;
E ndë zemër aq thikata[282]
Prë sa rrotul[283] dosa ish;
Bëjme me hirrën[284] Zoti Krisht
Bej të i shoh me çerë prëmist!?[285]

Si pa shoqe bëtëtin mua
Qofçin gjith pa shoqe ata.
U gremistit ndë një përrua
Kush si kallogre më la.
Kriet i preçin, e ndë ka bilj
Gjith ja shtiptët një dërstil[286].

Divotja e rreme

Katarina cila thoj
Paternostrin me vjet
Fjalë të shtrembëta, buftoi,
Të ish divote ndë këtë jetë
Me ca bëna paganishte
Keq më shumë se krështërishte

Nisi e vate, e keq njëhere
Sualli spartën[287] ndë shtëpi
Po të bëj një frunkulere[288]
Si ngë e bënej mosnjeri.
Mbë vurtet e çeli e vej
Rreth asaj këtej e atej.

Tuke thënur cado fjalë
Çë i ndigonej vetëm ajo
E shtrëngohej si një ngjalë
Jasht nga ujit: e maj ato
Desh të mpësojë njeriu e bëj
Gjithnjeri të mund i xëj.

282) *thikata:* goditje me thikë;
283) *rrotul-i:* masë peshe;
284) *me hirrën:* me të drejtë, me hir;
285) *me çerë prëmist:* me çehre përmbys;
286) *dërstil:* dërstilë, valanicë;
287) *spartën:* gjineshtrën;
288) *frunkulerë:* zjarr me flakë, flakada;

Scanned with CamScanner

Tuke vat këtej e atena
Afër zjarrit e tue bënë
Ca shënkime[289] hapej shena
E më gjin mblidhej prë nënë;
Ish je pjote gjitonia,
Je ajo thoj gëzot[290] Maria!
E thërritij me një zanje[291]

Si kumborë rgjendullore[292],
Ndo çë e gjegjënj, mëngu hanje
Prë jo ninë triëmbëlore[293].
Pjafshin gazeshi tue ruar
Njerëzit, e ajo me duar.

Mblidhij urt e vëj më sparta.
Po të bëj zjarrin më të madh.
Lamë sa të vejin aq të larta
Po sa dit dukej ndaradh[294]
Djejmit zun të i kaptojin[295]
E thërritjen e këndojin.

Ajo kish gust e hare
Sikur bëhej një shurbesë
Keq të mirë e pjot me hje:
More thom se kish për besë
Se për të kur të vdisij
Zoti Krisht mposhtej të e nisij.

Bjerrafates[296] një shkëndil[297]
Tek zilona ju ngalos
E një verë i bërë ndë ilje[298]
Kur u adunar[299] u stros

289) *shënkime:* lëvizje për isharet;
290) *gëzot:* gëzoftë;
291) *me një zanje:* me një zë;
292) *rgjendullore:* prej argjendi;
293) *ninë triëmbëlore:* ninullë shumë e ëmbël;
294) *ndaradh:* fis, bark;
295) *kaptojin:* Kapërcenin, kaptonin;
296) *bjerrfates:* fatkeqes;
297) *shkëndil:* shkëndijë, xixë;
298) *ilje:* ije, kryqe;
299) *u adunar:* e kuptoi;

Ndë ca balta se të shuhej
E u ngja mbjatu si dukej.

Strosi e jëma me një shkop
Se të i njomij brinjëzit,
Tue thërritur si një lop
Bin e qerfshin njerëzit.
Thirr e jëma e bilja atje
Bën të mirë një mirr e lë.

SBESULLORI[300] MALLKONJÉTAR

Paskaluqi çë kish vrarë
Një derkth sa një gadhur
Hëngri mirë ndë Kalivar[301]
E ndë kreshëmet; pra kur
Erdhëtin pashkët agjëroi
Ruanej njerëzit e shërtoi[302].

Ki vandohej tuke thënë
Se nëng njihej zotën Krisht,
E te qisha maj kish qenë.
Moj në ditë çë i hanej mishtë
Pas të asaj grazoi[303] si kal
Shkau e çajti atje një shal!

Oh sa Pashkaluqera janë
Çë ndë qishë jo vet ngë venë
E ndë prëmte pinë e hanë
Mish, e sa përpara i vjen,
Moj së dine të thon një fjalë
Pa një mallkuame sa një malë.

E përshanjin perëndinë,
E tërpërojin shenjtërat:
Skandalepsnjin[304] njerëzin,

300) *sbesullori:* ai që nuk beson, që blasfemon;
301) *kalivar:* e kremte paganishte;
302) *shertoi:* psherëtiu;
303) *grazoi:* hipi te grazhdi, kapërceu;
304) *skandalepesnjin:* bënin skandale;

Scanned with CamScanner

Thua mbë tij: e prerë të qoftë
Dora çë ijzit bën e pe[325]?!
Pra i përgjegje edhe pa hir
Se të verë shëndoshë e mirë.

RREMÉTARI[326]

Rrafanieli vreshtën e tij
Ruaj e tek e tjerët haj
Ndo të flitij thoj, se s'dij
Petkat e njerin, e laj
Duart, e bënej si Pilati:
Moj të mir udhën ngë e mati!

Gjithata që qenë të ngarë
U ndiguan e bën kuvend:
E një dit çë ng'u vindar[327]
Gjithë mbë qetës e pastjend[328]
Van e i voljëtin vreshtëzën
E si bëri atij qe bënë.
Kur te vreshta i murgu vate
E m'e gjeti tas të vjelë
Zuri faqen me shplakate[329]
Ture thënur: Ndë të mbjelë
Ka të ruhet mirë njeriu
Se çë mbuali ata i bin!

Para e prasma ndë vërteta
Qe kjo çë i duall nga golja
Semre bënej si shigjeta
E si zorrat prë ndë kolja[330]
Më të rreme mfilarosij[331]
Se pa nxorra nëng shkalosij[332].

325) *bën e pe ijzit:* të bën të të dalin xixa nga sytë nga dhembja, torturim;
326) *rremtari:* gënjeshtari;
327) *ng'u vindar:* nuk u pa;
328) *pastjend:* pa bërë shumë punë;
329) *shpakate:* shuplakë;
330) *kolja:* kolendrat; këtu në trajtë të apokopuar për efekt rime;
331) *mfilarosij:* vinte në fill, rreshtonte;
332) *pa nxorra nëng shkalosij:* pa rreme nuk dilte mirë;

Së dij të thoj mëngu një fjalë
Pa të thonej një të rreme.
Ka gjërpëra bëj një mal,
E të shitura e të bjeme
Pavantoj[333], e vej ndë thes.
Ndonjë galuf çë i kish besë.

Pra çë e njohtin mosnjeri
E mirr vesh o i vënej re,
Tas çë dijin se ndë tri
Fjalë trirreme vej ndë hje,
E nga golja e tij vërteta
Dil si arrëza nga bleta.

SHËRBEJÉTARI

Nakaruqi kish një pjënc
Çë e ngushtoj e bëj të gjerë,
Si mirr bukën ndë vëllënxë[334]
O shërbej prë të, e prë tjerë.
Kish di shatra, një të lezë,
Një të rëndë, e kaq një brez.

Kur shërbej për të shtrëngoj
Pjëncin fort me brez të gjerë
E me shat të rëndë rrëmoj.
Bukë e qepë ndë dimër e verë
Haj, ne semre mund e kish;
E kurraj prëvonej misht.

Vej pa brez e pa u shtrënguar
Kur shërbej prë të tjerë
E me shatarjel[335] ndë duar
Të ish ndë dimër o të ish ndë verë.
Katër her lipij të haj
Hjoromer[336], bukë e mëraj[337].

333) *pavantoj:* mbahej më të madh;
334) *vëllënxë:* (it.) balancë, peshore;
335) *shatarjel-i:* shat i vogël;
336) *hjoromer-i:* proshutë;
337) *mëraj:* rrepkë;

Scanned with CamScanner

Murmurisij e rëkoj[338]
Mos nk' i shkojin verën edhé
Keq ashtu shokët mësoj
Se të bëjin, me këdo qe
Semre u zu, se i paguar
Ish përpara, e u kish harruar.

Pra çë haj e pij më mirë
Mbë hare vëhej si zot
E shërbej ashtu me ghir[339]
Sa të bëj ndë motë mot
Më se njetër bëj një ditë
Çë ndë menate mbrëmën prit.

Ndata ënde si një hu
Ndreqej shtuara e zej të flitij
I kumbisur[340] ndë mërun[341]
Të së shatit, e thërritij,
E rrëfiej dica storia
Po të i gjegji shoqëria
Semre i shitur si kusi
Të penguame nga saturi[342]
Qellij dhunë miq e gjiri.
Moj ndëmot çë kuarej gruri
Bëj shërbise çë se mund thuhen
Se nga nxërra njerëzit kruhen

Katër bila qell[343] me të
E të shoqen çë ish harpi[344]
Cila ng'është kutjend me një
Gojë të pjotë e semre rrij
Je zbramarme[345], e më dëthin
Sa jo drunje një kaminë[346].
Ture kuartur dorën hapij

338) *rëkoj:* rënkonte;
339) *ghir:* hir;
340) *i kumbisur:* i vendosur, i ngulur;
341) *mërun-i:* bishti i shatit;
342) *saturi:* ai që mbledh taksat;
343) *qell:* shpie;
344) *harpi:* figurë mitologjike, zog i shëmtuar i ferrit;
345) *je zbramarme:* e pangopur; që ha e s'ka të ngopur;
346) *kaminë:* oxhak-u

E kallinjët më të rënda
Lëj të bijin. Shoqja e mbrapij
E, mblidhij keq me ënda.
E të bilat nëng e lëjin
Hjerovolin[347] tek e gjëjin

Më se vrúkulit[348] nga shkojin
Mblidhjin gjith, e kallamen[349]
Aq të bukur e qërojin
Sa pra, punónjeri[350], dhenë
Gjëj të vetëm; mëngu kashta
Mblidhjin prana ghorat[351] prëjashta.

Ndë katund ku ish i lerë
Njihëjin mirë kta shërbise
E ngë i pa të ditën herë.
Moj ndata të huaja vise
Nakuriqi ndihej keq
E ng' shërbej, si duhej, dreq.
Vet një ditë mpero për vend

Bëj, se jetërën nëng e duajin
Sepse gjith i lëj skutjend[352].
E ndë si, njohur, e ruajin.
Njëra prë çë diq ndë hi
Se ng' e deshi më njeri.

MJESHTRI DRUJTAR[353]

Natën e ditën tuptisij[354]
Mjeshtër Anemi ndë një katoq
Errëtulor[355], ku mund vëdisij
Edhe trimi më i doq[356]

347) *hjerovolin:* dorëz gruri, duaj;
348) *vrukulit:* vjedhësit;
349) *kallamen:* kashtë gruri, llashtër;
350) *punonjeri:* ai që punon;
351) *ghorat:* tokat jashtë, horat;
352) *skutjend:* të pakënaqur;
353) *drujtar:* druvar;
354) *tuptisij:* bënte tup-tup, trokëllinte;
355) *errëtulor:* i errët, pa dritë;
356) *i doq:* i fuqishëm;

Scanned with CamScanner

Moj ai atje tue mbetur
Pak e pak u kish adetur[357].

Pritij, ndaj e shkatërroj,
Pra ngolisij[358] e përziej
Sa dërrasa mund të çoj
Ndose krimbi e miu gërriej.
Tetë o dhjetë shërbeme nisij
Pra ndë tjera motin grisij.

Bëj sënduqe, triesa e dera
E dritare e vëngarjele[359]
Katarrata[360] me grurera
E stamare[361] e gamjele;[361/1];
E vandohej se të bëj
Akuilën[362] çë ndë ajër fjëj.
Moj dritarja pas di muaj
Bin e shihnjë të ilëzuar[363]
Qiellin, e je hapur së duaj;
Se je hapte kish qëndruar,
Nga gjithë vendet prë vetëhenë
E të nxirrej atë pemë.

Te senduqet ndë mërkat[364]
Vejin brumbulit[365] e mit
Tuke bënur rumuratë[366],
Maçja s'kish ku të vej sitë
Se nga vendet gjith të ndajtur
Lëjin të ikijin pa i mbajtur

Thanë se ndë të tjera bëna

357) *u kish adetur:* ishte mësuar, i ishte bërë adet. Këtu është për t'u vënë re se përdoret turqizma *adet* që nuk ndeshet në të folmet arbëreshe; mbase Santori e kishte marrë nga gjuha e shkruar shqipe e mëmëdheut;
358) *ngolisij:* bashkëngjitte;
359) *vëngarele:* stol, ndenjëse;
360) *kataraat;* kapanxhë, derë që hapet në dysheme për të zbritur në haur;
361) *stamare:* ?
361/1) *gamjele:* mbajtëse prej druri të bigëzuar në të cilën varet derri i therrur; mangur,
362) *akuilen:* (it.) shqiponjën;
363) *të ilëzuar:* të yjëzuar, me yje.
364) *mërkat:* treg, pazar, merkato;
365) *brumbulit:* brumbujt;
366) *rumuratë:* (it.): zhurmë;

Një mbarot çë gjith i shkon
Poni natën pjotë bëna.
Iljet vrën e i mbulon.
Zoti Ndre deshi të bëré
Triez e gjeré për katër llëré[367]

Kish një bir e të e martoj
Afër ish, e duaj andaj
Tries e gjeré, ku të mbitoje[368]
Gjind së madhe, çë kurráj
Qenur ish ndë atë pullas[369]
Ka gjirit ndë horë tas.

Mastranemi i tha: më nget[370]
Të të shërbej si meriton
Ndë mjeshtëri u i vet
Mund të bënj sa ti kërkon,
Ndë tri dit t'e sjell të bëré,
Të limother[371] e të tërë.

Shkruan tri muaj e zoti Ndre
Nëng e pati triesën.
Mbë një shkazun[372] njetër tre
Gjëj Anemi pa e lënë
Të mëritur, të paguhej

Diti mirë, më se ngë duhej
Mbë serpos[373] i nditij keq
Turp, e triesen ja e bëri
Të ngolisur[374] gjithë pre dreq
Se me gozhda nëng ja tëri[375]
Gjithë harem ja qielli, e Ndreu
Se të haj ja parashteu[376].

367) *llërë:* llërë, pash. krah;
368) *të mvitoj:* (it.) të ftojë;
369) *pullas:* pallat;
370) *më nget:* më takon, më bie;
371) *të limothër:* të lëmuar;
372) *shkazun:* justifikim;
373) *mbë serpos:* në fund, në mbarim;
374) *të ngolisur:* të bashkëngjitur;
375) *nëng ja tëri:* nuk ia ndëndi, rrasi, futi;
376) *parashteu:* shtroi, ndreqi;

Scanned with CamScanner

Haj Anemi, e tuke pirë
Ver di vjeçe mbëlij një si
Vej mbë të tue thënë: i mirë,
Keq shërbesi, e gaz i ri
Ka të me jetë kur hanë këtu;
Dasmëtarët e thom se u

Kruajti kriet, u ngre e vate
Se të bëj ndonjetër mbroljë
Pas një javë, një lege[377] e gjatë
Rrij ndë tries; me hapte gojen
Se te haj, e triesa ish
E ngarkuar, vidhënxje kish
Gjith të mirat mbal[378]. E shtitur
Thom se nga njëra anë, u nis
Pa të mund e kishin ditur,
Gjith u zgjidh e u gremis
Mbi vetëhen, e u përziejtin
Sejat[379] posa iin, e u lejtin[380]

Dasmëtarët, e më shpëlqeu
Se të nuses te podhea[381]
Një tajur[382] me lëng kërceu
E i bëri sa folea
Të një korbi konter e gjerë[383]
E i gremisi cohën e bjerë
Katërzet[384] dukat; një lip
Që ndë shpi për dënim pasur.
Gjithnjeri me hund si pip[385]
Mir shërbesin tuke masur
Nisij, e vate se të haj
Ndë shtëpi buk e mëraj.
Zoti Ndre bëri: popo

377) *lege:* turmë, ndreqi;
378) *mbal:* mbi, majë;
379) *sejat:* gjërat, sendet;
380) *u lejtin:* u lyen, u bënë me lyrë;
381) *podhea:* fundi i rrobës;
382) *tajur:* pjatë;
383) *konter e gjerë:* frz. kryq e tërthor, gjerë e gjatë;
384) *katërzet:* tetëdhjetë;
385) *pip:* llullë, pipë;

Prë shërbesin çë pësoi:
Mastranemi i thoj: çë do?
Kush ftesi? Kush ngarkoi?
Triesën me vidhuxje shumë
E me verë çë bëj një lumë.

Hekurtari

Brumblisoj[386] për nat e dit,
Prë ndë gjith gjitoni,
Çë nga një te jetri vit,
Ndër të tjera e vet një shpi.
Ish ajo ku shtipej hekur
Mastër Rrafi[387] çerë i pjekur

Dhjetë dishipuj kish me të
E sa jip një kopane[388]
Njetër dhjetë bijin ndatë
Gjithë fishkëllejin me haré
E të bëjin një armoni
Çë kush gjegjij vetëm e di!

Ai Vullkani çë ndigoi
Se shurbesi nëng pëlqei
Njerëzvet vate zgavoi[389]
Një putig[390] ku të shurbei
Nda to largu e thella male
E ndë gjera e shkreta cale[391].

Prë dishipuj me xhudicë[392]
Zgjodhi burra me një si
E të shurdhër, se këtë fixë[393]
S'mund e bënej mosnjeri

386) *bumblisoj:* ushtonte, bënte zhurmë bum e bum;
387) *Master Rrafi:* Mjeshtër Rrafi; zbunim (diminutiv) i Rafael;
388) *kopané:* goditje me çekan;
389) *zgavoi:* zgortoi, zgavroi, hapi zgavër;
390) *putig:* (it.) dyqan;
391) *cale:* brigje;
392) *me xhudicë:* me kujdes të veçantë;
393) *fixë:* punë;

Scanned with CamScanner

Çë të tërë kurmin e kish
Ç'i tërë në skiset[394] ish

Master Rrafit (cili maj
Xuri ndo Vullkani qe
Nxjerr nga qielli prë sandaj[395]
Se rëmur[396] bëhej atje).
Pak i dhëmbij se gjëmoj
E katundin gjith shurdhoj.

Se të thomi pra si vete
Dreq shërbesi, nter[397] i nget
Se të bënej me duar të shpetë
Çë do lipset te kjo jetë
Hekurisht. Duanje një thik
Një pjuar o një limik[398]

Gjithë të i bëj. Po kish një vix[399]
Se nga hekuri tri pjesë
Me të hollith artific[400]
Bën e shkoqshin. Turres[401]
Duaj pa kund, të pinej verë
Me një gilic[402] si lumi i gjerë.
Sod i thonje se një shat
Tij të lipsej. Një të thoj
Se të e bëj njera menat:
Pra një muaj almeno shkoj.
Mpero semre aj shërbej;
E të shërbierit ku i vej?

Nëng e dij të i thoj njeriu.
Ish si orsi çë dëthinë
Uja sipras, e në gremi

394) *në skisët ish:* në pasion, në ndjeshmëri, në dëshërim;
395) *prësandaj:* prandaj;
396) *rëmur:* (it.) zhurmë;
397) *nter:* nder;
398) *limik:* kazan rakie;
399) *vix:* (it.) ves;
400) *artific:* (it.) goditje e lehtë;
401) *turres:* të holla, pare;
402) *gilic:* fyti;

Thom se prana bëj lavin[403];
Semre i xheshur, liverisur[404]
Vej, e i shqerrur e i grisur
Në ja thoj njeri hejmohej
Me këdo të ish ngreshtej[405] e zëhej;
Hidhej, e pastaj fitohej
E si vajtë i njomith bëhej.
Mblidh turp e kopané
E gjëllij ashtu mbi dhe.

PUTHIGARI[406]

Me tri lira zu të bjej
Kokotati, e të shitij ver;
Semre gjimsit gadhënjej
E i hejmuar dukej ndë çerë
Thoj se së kish gjë katundi
E je bëj për miqëri

Të dicave çë lutojin[407]
Se të kin një qelq i mirë
E sa duaj nëng e paguajin
E ja sillij për piaxhir[408]
Moj një mik jetrin thërriti
E më shumë i prasmi piti

Prë të parëzën me vucë[409]
Shiti shehuraz, pështaj
Mbrazi, bute, e ndonjë puc[410]
Kish ng'i sosij. Si mërajë
Hajin semre ata pitarë
Më i paguajin ar e bar

403) *bëj lavin:* bënte rrëke;
404) *liverisur:* i bërë lëvere-lëvere, me arna në rroba;
405) *ngreshtej:* grindej;
406) *puthigari:* shitësi, dyqanxhiu;
407) *lutojin:* lutnin;
408) *piaxhir:* (it.) e mirë, kënaqësi;
409) *vucë:* enë për të mbajtur mushtin, vozë;
410) *puc:* (it.) pus;

Scanned with CamScanner

Zu ndë krah të çotravet[411]
Të zgjeroj buthikëzën[412]
Dica vejin me shëndet
Ai semre tuke u ngrënë
Bjenej ver të mirë, të zezë
E me uj e bëj të lezë.

Gjith me uj i pakëzoi
Ndë ishin turkëra[413] të lerë:
Moj ata si mëlingonat
Më rrëidhëjin ndë raciona[414]
E mos jetër i vobëktoi
Mos ngë i bëhnej të kërshterë
Kur i pa se kin të gjata
Veshët muari me fuqi.

Duart i hapi si lopata
E koprë, e bajt e hi
Mblidh, e atij sa vej ndë duar
Një mbë ërgjënd gjendej ndërruar
Zu të mahej e golotën[415]
Duaj më të ëmbël e të pjotë.
E je shoqja çë divotën[415/1]
Bëj, të qajin me më lot
Thartulore[416] gjinden shtij
E nga qisha vej e vij.

Di masore[417] mbaj i shpejti
Një të drejtë e rremtare[418]
Të jetërn, e shiti e bjejti
Semri ashtu. Kur fare fare
Thoj ai se gadhnjei
Për di her shitij sa bjej.

411) *çotravet:* të çmendurve;
412) *buthikëzën:* dyqanin;
413) *turkëra:* turq;
414) *raciona:* uratë
415) *golotën:* gojën, fytin;
415/1) *çë divoten:* që besonte;
416) *thartulore:* e hidhur;
417) *masore:* masë, peshëore;

Kur çë bjej gjë gjë njeri
E zgualarëshin ndë precë[419]
Mirrij be mbi bil e si
E të rremen thoj për vezë
Gjith e njohtin se kalloi;
Mosnjeri të flit guzoi.

Kur të majmit ju ngallos[420]
Ndë gëlic[421], i mjeri vet
U fukar[422], posi një dos
Çë haj eshtëra, cila u gjet
E spovisur e je fritur
Me gërlacin të mbulitur.

Patën gust ahierna gjith;
E të shtrembur posi jan.
Zun të i fjitjin prapa vith
Njerëzit, e një mijë i thanë
Tuke vjedhur keq u mah
Thojin, murgu, e nani ra!

MUSHKÉTARÉT[423]

Kur i mir e lipisjar[424]
Pjono hir e karitat[425]
Krishti, vate mbi Kalvar
Se të bënej një dhiatë,
Ture dekur, me njerinë,
Po të i jipij lefterinë[426].

Ndrishe njerëz më e shoquan[427]
Ka rromant e ka judheti

418) *rremtare:* e gënjeshtërt;
419) *zgualarëshin ndë prece:* nuk ishin dakort me çmimin;
420) *ju ngallos:* i ngeci në fyt;
421) *gëlic:* fyt;
422) *u fukar:* u mbyt, ngordhi;
423) *mushkëtarët:* ata që mbartin me mushka;
424) *lipisiar:* ai që ka mëshirë, i mishërshëm;
425) *pjono hir e karitat:* plot hir e mëshirë;
426) *lefterinë:* (gr.) lirinë, dritën;
427) *shoquan:* shoqëruan;

Scanned with CamScanner

Moj ndë kriqe kur e shtruan
Inë atje sa janë ndë jetë
Gjithë nacionashi[428] po gjind,
Mbi mijar, jo se mbë qind.

Thanë mpero se atje ngë qenë
Mushkëtar e qerrëtar[429]
Bashkë me tëjerë, të jipjinë penë
Kur mbi kriqe e patëtin vrar;
Moj si vate çë këta
Pjesë ngë patëtin me ata?!
Populli çë cadoherë
Është i urt e është profet
Na përhapi një mister
Ligjërisht e me vërtet.
Andaj vete tuke thënur

Se këta njerëz mbi dhe të lënur
Qenë, të vënë jetën mbë kriqe
Ka njëmend, e ndë shtridhore[430]
Të i shtrëngojin si rrëshiqe,
Ku qe vajë; e ashtu hejmore
Të gëllinjë sa rron burria[431]
Prë ndë lipe[432] e ndë hidhia[433].

Kush e shkruajti këtë stori
E përvoi për vetëhenë,
Se tue vatur prë fani[434]
Tu këtje, tuke ecur dhenë
Ndodhi[435] semri mushkëtar
Gajdhuras e qerrëtar.

Sa gjëlliti maj u zu
Ai njeri me këdo qe

428) *gjithë nacionashi:* gjithë kombesh;
429) *qerrëtar:* ai që punon me qerr;
430) *shtridhore:* shtrydhëse vaji;
431) *burria:* burrëria, njerëzimi;
432) *lipe:* zi, mort;
433) *hidhia:* hidhërime;
434) *fani:* fat, destin;
435) *ndodhi:* ndodhi, takoi;

Mushkëtarët e bënë pa tru,
E u ngroh këtu këtje
O për të shtrejtën prec[436] çë deshtin,
Ose vodhëtin e je xheshëtin.

Mosnjëherë pa një shënim
Shkoi, sa herë vate me ta
Njihen gjith e kanë ndigim
Posi dirqit; e dica
Njëri me jetrin nëng paditen
Ndo të zëhen a të vriten
Kur të ngrënit i kalluan
E mbi gjith ndopati verë
Ja dëthitin e i mbjuan
Pra me ujë rogjenë[437]. Më herë
Eci murgu, e agjëroi
E qerrasi[438] pjëncin mbjoi
Me gjith duak[439] njëherë i muartin
Ca djath, e verë e mish
Bërë ndë furrë. Ndë njetër herë i shquarëtin

Një panarez, tek ku kish,
Me ca verë, një gjel i pjotë
E je lanë esull si çote!
Ndo të i flitej një filar[440]
Para ndrequr me të rreme
Ki ndë gol ata vjedhëtar
E me faqen po të treme[441]
Thojin se vjedhëtar zi
Ish, çë duaj nani!
Njetër herë një qerrëtar
I kish dhënë kapar një copë;

Prana vate një bujar
Çë do të ecij mbë gallote

436) *prec:* (it.) çmim;
437) *rogjenë:* shtëmbën, katruvem;
438) *qerrasi:* qerraxhiu;
439) *duak:* duq, hejbe;
440) *filar:* ligjëratë;
441) *të treme:* të ngurtë, të prishur;

Scanned with CamScanner

E qerrasi më e lëshoj
E nga copa as ndikuroi[442]
Dimbëdhjetë solde njëherë
Taksi njëj se të i qellë.
Një munduqith[443] gjat e i gjerë
Sa një pëllëmb e pak i thellë
Ndë një vënd i afërt e ai
Më i rrëmben njëzet e di.

E ndë gjithë duaj të rrëfiejë
Sa pësoi më keto gjind
Kush çë shkruan, sa karta ngjiej?
Duhiçin qind e mij mbë qind?
Moj mpero sosën sa tha
Të xëmë gjithë kush janë këta.

VJETHËTARJA PULASHI

Anëmaria shërbej të rritij
Pula e gjela e një mixore
Ka gjitonet motin pritij
Se të bënëshin madhulore[444];
Ja kalloi, e me ca tjera
Bëj tumac[445] e haj, e mjera?

Anëmaria saher çë gjëj
Se i mangoi një pul e një gjel
Dil te shkallë e thirr e bëj
Si një madhith këmporjel[446],
E dërgoj të zezën ëmë
Çë njeriu ngë i bëjin dëm.

Moj ca bëna keq të rënda
Perëndia ngë i do:
Ra sëmur mixorja e mbrënda
Zuri krimba, e mëngu ato
Van të gjëjin, mek u mbashk
E tue ngrënur u mbjuan si mashk[447]

Diq e kajbët e njeri
Kur spovisi nëng i pati
Një thërrimez lipisi.
Kur e ngrëjtin qejbej shtrati
Si një grop, e prifti edhe
Largu asaj mbahej tutje.
Di çë e qellëjin kin të mbëlirë[448]
Hundat me nje skamantil.[449]
Mosnjeri më e qaj, o mir
Thoj asaj, o motër o bilë,
Moj sa e shihëjin nje kujtonëshin:
Hëngri pula, e liga?! Thonëçin,

E mallkuame ashtu nga gjithë
Shkoi e vate ajo ka dheu
Cila dogji e shpoi si hith,
E një ndonat të lig lëreu!
Gjithashtu kan desën ato
Çë han pula posi ajo.

VASHËZA ÇOTËZ E GJITONJA E SHPEJTË[450]

Gjith e bukur, baxhanele[451]
Ish je bila e Juljes
Vej te kroi me tri ranxhele[452]
E me duar mbahej ndë mes,
Tundej shkundej sikur të ish
Pjot me pjeshta e një nkë kish.

Qeshij e buftoj ca dhëmbë
Dhia si breshër bardhulorë
E të vogëlaz ato këmbë
Dilikatez atë dorë.

442) *ndikuroi:* shoh, ndjej, perceptoj me anë të shqisave;
443) *një munduqith:* ?
444) *madhulore:* të mëdha;
445) *tumac:* peta, makarona të bëra në shtëpi;
446) *këmporjel:* këmbanë, tellal;
447) *mashk:* një lloj pushkaliqeje për të shkrehur në ditë feste;
448) *të mbëlirë:* të mbyllur;
449) *skamantil:* shami;
450) *e shpejtë:* e zgjuar, dinake;
451) *baxhanele:* babaxhane, naive;
452) *ranxhele:* shtëmbë;

Scanned with CamScanner

Posa trima kish katundi
Gjith ajo mbë mall i tundi!
Pas i vejin posi vete
Rreth linarit[453] *pallarea*[454]
Ajo shpejtë si shigjetë
Ngrehej ndë ajër, lehtë si rea.
E me shoqet po vantohej[455]
Se ngë duaj, në mos martohej.
Ndë aq të nisura kushqi
Së dij të mirrij o të lëj:
Lip andaj nga ato vuli[456]
Si shurbesin kish të e bëj
Dhunë e qellëtin[457], *e ajo*
Së ndigoi çë thanë ato.

Një gjitone ndër të tjera
E vindarit[458] se ndë tru
Pak o fare kish e mjera
Kripë, e të porsinej zu
Të i kallojë të jëmës gjë
Se ja mbaj e rritij më.

Paparelja i pati besë:
Pruar e vate ndë shtëpi,
Muari atje një konjën e fes[459]
E je mbjoi me lesh e li.
Nisi prana leth e qet
Të ja qell gjitones vet

Thoj asaj: nji nje nji nje[460]
Bët me tjerrën se kam bënj
Di o tri linja, njota[461] se
Diç kam, u bënë si rrënjë

453) *linarit:* kandilit, fenerit;
454) *pallarea:* flutura;
455) *vantohej:* mbahej krenare, mburrej;
456) *vuli:* vullnet, mendim;
457) *dhunë e qëllëtin:* kritikuan;
458) *vindarti:* zbuloi;
459) *fes:* thes i madh;
460) *nji nje:* shpejt e shpejt, menjëherë;
461) *njota:* ja, qe;

Mëma fare së më kujton
Pafça e ajo ngë e ndikuron!

E gjitonja thoj asaj:
Bila ime, ti nani
Tas u rrite, o ndose vaj
Ndë linar të vësh ngë di
Gjënde prana ndë errësirë
Pishkalaqe[462] e pa të mirë.
Bëj nani çë mundën e ke
Lefterin të bësh gjë gjë
Se kur e martuame je
Më të rritur tek e lë
Ti e gjen e trashigon;
Moj ndo së vjove mëngu çon!

Ditën e jetër, qet e lezë
Qelli asaj e urta vashë
Grur'e mel; e prë një kezë
Çë të i bënej, ca mundash;
Vaj, lathure fiq edhé
Të ja shitij më tutje.

Moj gjitonja me xhindicë
Mirrij, mblidhij e i rritij
Prë vetëhenë. Ki artifix[463]
Dreq vërteta atira i gjitij
Çë venë ujë ndë shosh, e mbanjin
Se më të finjen kan lanjin!

Pas një jav çë u kish martuar
Dreq si gjendej nuse e re,
Duall e vate tue kërkuar
Prë gjitonen, e cila nke
Se kish të gjegjij e sa shihij
Se ajo vej, shehej o ikij.

Mbë serpos një ditë ju poq
Ndë një rrug je ngushtulore

462) *pishkalaqe:* lakuriqe;
463) *artifix:* marifet, artific;

Scanned with CamScanner

Zu të i fjitij, me zë të doq,
Lastimisej e je dirrore,
Po ka ti si shoh mbë zi,
Je se t'jerët ndë amahi?![464]
Do të me i japç o thom se jo
Gjith shërbiset çë të dhe?
Të më i mbanje? E verdhë ajo
Dhia si hitë mbë çere, pa tre
Ju përgjegj: o bila ime,
S'di çë thua? Për gjellën time
Si nk' e di? E kërpt e litë
Çë të solla ku me i vure?
Mos e hëngtërtin thom se mijtë?
Grurët e melt e ato lathure
Çë të dhe? Di tumen fiq
Ku i gremise? Ndë furriq?!
Motra ime, ndë vurteta
Këto fjalë më thonje ti
Dreq këtu si jam e u gjeta,
Bën e vjerrëshnja nani!
Mike qem, e mike jemi
Moj nteres së pattim o kemi!

E thua ti me faqe guri
Se nderes ngë pamë, e kur
Dialli tij ndë zemër vuri
Të më porosinje, keq me kurë[465].
Të kalonja gjë ndë shpi
Se m'e vjonje me amahji.
Ngë ishnje ti ahiena[466] Pjake
Tradhizore[467], rremtare,
Dejpër e ligë që stise ljaqe
Trufarishi[468], e s'pate fare
Nderë ndë faqe? Ngë ishnje ti?
M'e rremton këtu nani?

464) *amohi:* luftim, betejë;
465) *kurë:* kujdes;
466) *ahiena:* atëherë;
467) *tradhizore:* tradhtare;
468) *trufarishi:* që ke punuar për të gënjyer;

Popo, popo! Më shpëlqen[469]
Se kushkia[470] të bëri dëm!
U t'e thom nani me pen[471]
Se të ka zënë ndonjë nëmë!
Dolje trushi[472] , u lave[473] o bijë!
Qelle lijipin ndë atë familjë!
Shtij nga çera[474] farmëkë[475] e zjarr
Mathalena e rrij t'i hjidhej[476]
Se t'i bëj të mirë një barrë
Me të rrahura; moj mblidhej
Më e më gjind tek ajo udhë
E je murga ra ndë kudhë[477]

Ndër të tjerit që rrakuan[478]
Ish i shoqi, i ati e jëma;
Kur shërbesin[479] mirë ndëguan[480]
Me mallkime, fjalë e nëma
Bënë atje si një markat[481]
Murmurishi[482] i gjerë e i gjatë:

Kush thërritij nga një vend:
Kush nga jetri kanosi[483]
Bëj të rënda: e kush kutjend

Qeshi e po thoj: një bri
Merr nani? Të qethi mir
Lesht e të qeroj me hir!
Mathalena ra cali[484]

469) *më shpëlqen:* më vjen keq;
470) *kushkia:* martesa;
471) *me pen:* me hidhërim, me keqardhje;
472) *trushi:* që e ka lënë mendja, i lënë trush;
473) *u lave:* humbe mendjen;
474) *çera:* fytyra;
475) *farmëk:* vrer;
476) *hjidhej:* t'i sulej;
477) *kudhë:* kudhër;
478) *rrakuan:* arritën;
479) *shërbesin:* ngjarjen;
480) *ndëguan:* kuptuan;
481) *markat:* pazar;
482) *murmurishi:* thashethemesh: markat marmurishi: pazar thashethemesh;
483) *kanosi:* grindje;
484) *ra cali:* i ra zali, i ra të fikët;

Università della Calabria - Biblioteca Umanistica

Scanned with CamScanner

E qëndroi sikur e dekur:
Marr, e qellëtin ndë shpi
Moj gjitonja si një hekur
Ngurrtulore[485] thoj: ndo kini

Martëri, të zotërat jini.
Të më thoni gjithë këto,
Se në mos ju bënj ngales[486]
Se më kaluarti ajo
E martuame me ftes?
Qetëtin gjith, e ajo kaluar
Mir u gjend e petkun[487] muar!

KOPILJA

Natalina qe je mir
Prë sa mbeti ndë shtëpi
Bashk me të ëmën, cila nxir
Prë ndë gjithë gjitoni
Ca novele[488], e thoj se po
Ngë ish mbi dhe njetër si ajo.

Ish e bukur si një lule:
Shpejte ish si dallanishe
Më vëlej se një cakule[489]
Çë është pjot me xhoja ndrishe[490]:
Bëj shërbise prë me u ruar[491]

Pastërtore e nikoqire
Shpin të mbaj si një lartar[492]
Ish ashtu je fanëmire
Se nka bota të bëj ar.
U martua e gjith ata

485) *ngurrtalore:* e ngurtë;
486) *bënj ngales:* vë në burg;
487) *petkun:* pasurinë;
488) *novele:* tregime;
489) *cakule:* thes i madh;
490) *me xhoja ndrishe:* pasuri;
491) *prë me u ruar:* me t'u parë, që shihen;
492) *lartar:* altar;

Bardhë karizma[493] bëtënin, ça[494]!
Dia, si pasëri[495] kur bëj
Gjith këndimet e zogjëvet:
Cili, kur deshi të bëj
Rushinjolin[496] murgu, u gjet
I çotëjasur[497] e qendruar
Vetëjim e i harruar!
Vetëm dij të haj e të pij,
E të fjëj për nat e dit
Ngroht edhe ndë zjarr të rrij,
Çë nga një tek jetri vit.
S'dij të qepij e të tirrij
E ndë arnoj më shpejt çirrij
Bijt; e ngjeshij si një dru
Ngjeshnin vashazit ca her
Se të bredhin, e si një hu
Dreq i mbaj ndë prehër i gjer,
Prë të laj finjën dërgoi
Semre, e maj vate te kroi
Shpejt i shoq sillej me qerre:

Nxirr ajo me prehërma[498]
Nisi shpia prë ndë të zbjerrë[499],
E fëmija u vobektua[500]
Diq, e bijçi njëlloje[501]
La, pa fare gjë mbi dhe!

Hapni sit o burra e trima
Çë me gra duani të lidhi
Se jo semre shkrepëtima[502]
Qellin shiun; e kudo mblidhi
Gjeni vend të mirë pushoni
E për ngjaja[503] gjarpëra çoni.

493) *karizma:* të mira, bukurira;
494) *ça:* onomat, çarë;
495) *pasëri:* zog mali, trumcaku;
496) *rushinjolini:* (it.) bilbili;
497) *i çotjasur:* i çmendur, i marrosur;
498) *me prëhërna:* me prëhër;
499) *ndë të zbjerrë:* të humbur;
500) *u vobëktua:* u varfërua, u vobekësua;
501) *një llojé:* shumë, turmë;
502) *shkrepëtima:* shkreptimë, vetëtimë;
503) *për ngjaja:* për ngjala;

Scanned with CamScanner

KËNGËTARJA E NUSEVE

Ndë gjith nuset Kerecja vej
Semre e para të këndoj.
Mpero strofat i lirej
Dreq si kriet asaj i thoj:
Dij ca kënga copa copa,
E muitij[504] si bën lopa.
Pas asaj vejin të tjera
Tuke thënur një e njetër
Kënek, e pritij të arrij hera
Të diftonej gjë të vjetër
Ndato udha tue shkuar
Nusezën të pabesuar

Pas besuamet njetër ënda[505]
Pra ndë zemërat i hij,
E kërkojin të ishin brënda
Ndato vende, ku të i vej
Mbarë të rrëmbejin gjë
Ka donjë sa mundij më.

Kanë të gjera ndën karçelet[506]
E të thella e duan të i mbjonjin
Më të dhëna; e më i çelët
Malli, se të marrin e vjonjin;
Posa shohin se ndonjë
Merr më shum, e thon atij
Pa zakon të gavënuar[507]
E pra bënin stesu ato
Posa bënë tjera më parë.

Thonë dhe se kujdo
Së qe dhënë si mir i ngitij
Të shërbehej, e je pritij?!
Dalën, e venë tuke u vantuar

504) *mujitij:* pëlliste;
505) *ënda:* ëndja, malli, meraku;
506) *ndën karçelet:* nën xhepat;
507) *të gavënuar:* ?

Kush më shum dhurim[508] rrëmbeu
E karçelën ka të mbjuar

Më të ndëndët, e kuj dheu
Vate rrotull, se u de(h)
Aq çë piu e i duket hje[509]
Thanë se Krecja i porositij
Se të bëjin aq turpri[510]
Pa u nguqur; pranë i rreti[511]
Posi deshi, gjith njeri
Dia si kish zakon, e vate
Keq adheti[512] mbë të gjatë.

Shkoj ka prindët ndë të bij
I pahejshmë[513] i bruti adet
Sa nani ndënjë fëmijë
Bën në spizë[514] një nuse vet
Se ngë bënjin dhet çë han
Fort, e ver më pin se kanë.

ËNGJËLIT[515] E NIPËRAT

Mirbëmi qe një burr
Çë shërbeu me trimëri
Nga një kalidhe[516] sa një furrë
Diti e stisi[516/1] një shtëpi
Eci dhenë, u rrit e më
Gadhnjeu semre gjë gjë.
Marr zakon e marr adet
Të shërbej, mëngu një dit
Mund të shkoj ashtu të shkret,
Se nganjë te jetri vit

508) *dhurim:* adhurim;
509) *hje*: hije, hijeshi, bukuri;
510) *turpri:* turp;
511) *rreti:* rrejti, gënjeu;
512) *adheti:* adet, traditë;
513) *i pahejshmë:* i pahijshëm;
514) *spizë:* shpenzim;
515) *ëngjelit:* ungjët, xhaxhallarët;
516) *kalidhe:* kolibe, kasolle;
516/1) *stisi:* ngriti, bëri, ndërtoi;

Scanned with CamScanner

Diavasij[517], shkruaj e bëj
Një shërbes kur njeter lëj.
Nka të vëllezrit rroj më shum
Vet ai në gjell disa;
Sepse vixet[518] si një lum
Shtu ndë varr sa qenë ata
E të bijët çë qëndruan
Ka të prindët ng' u larguan.
Pijin, hajin e të gjata
Kishin thonjtë e gjuhën edhe,
Pak rrëmojën ndë të thata
Dhera, e mblidhëjin pak atje.

Nga i ungjëli prtëndojin
Male e dete, e nënk e dojin
Fare mir; megjithëse i veshij
Më e më herë e-i gjëlliti
Ndë një vit i rëndë, ku xheshi
Uri[519] njerzit, e shtiti[520]
Ndë të thellë vobëkti
E i la pa petka e shpi.
Ndatë vit mos kishin pasur
Të ëngjulirin të lipisjar[521],
Mbë këtë herë u kin muhasur[522]
E të bërë nevojtar,
Mirëbëni hapi duar
E ndë gjellë u pan qëndruar,
Më i jipij e më kërkojin
Pa buftuar te ngopur kurrë
Prë sa mundëjin i kallojin
E je qellëjin dhunë; andaj
Rrisulvirti[523] të kërkoi
Një çë e duaj e ng'e kalloi.

Ki shërbes një shkundullim[524]

517) *diavasij:* lexonte;
518) *vixet:* (it.) veset;
519) *xheshi urit*: vdiq urie;
520) *shtiti:* shtyri;
521) *të lipisiar:* që kish mëshirë;
522) *u kin muhasur:* ishin mykur;
523) *risulvirti:* (it.) vendosi;
524) *shkundullim:* tronditje;

Prë të nipërat e të tjerë
Qe, e bëtëtin një gjëmim
Gjatullore keq të gjerë
Moj tue vatur mori pra

Bën e ruajti dreq dica
Panë se Mirëbëmi kish
Mbë vërtet një vix, moj pra
Nga jetër anë i veshur ish
Me virtuta, e prë ndata
Rishkëìqejin mirëria[525]

Fjaja e ëmbëj e lipësia
Së dij të thoj një fjalë të rreme:
Së dij të bëj një dëm njeriu.
Ndë të shitur e të bjeme
Së gjënjej; more, i ziu,
Dha për grur tridhjet qarri[526]
Se të mblidhij njëzet e di
Moj të nipërat nëng pushuan

Të thërritejin e të thojin
Kundër atij, e se ndiguan
Se më keq e ashpërojin[527]
Duke bënë ashtu: edhe
Thanë se do t'e vrisëjin. Sheh
Çë janë nipërat e gjiritë?!?
Ndë çë jep e bën të han

Si te djathi bënjën mijtë,
E të gjëllinjin me se kanë
Vixe, e ti shtrëngohe e griken
Mëngu lanë me uj, se të ikën
Prë trembim[528] si ata të mahen

Tuke ngrën e tuke pirë,
E të pastrohen, e të përlahen

525) *mirëria:* mirësia;
526) *qarri:* masë peshe;
527) *ashpërojin:* ashpërsonin;
528) *trëmbim:* frikë;

Ndë urtëri[547] i thellë e i vjetër.
Shkruaj kartucaz[548] prë riceta[549]
Më se lule shkon bëleta[550]

Për kininë mbanej ca miell
Të përzier me di u se çë
E sa ethe ishin ndë diell
E shëroi e nxir me ata:
Moj përpara më i qëlloi
Me ca shtog e bar alloi[551].

Me jodurin[552] pra të bëj
Kurat më të gjata e rënda
E kudo qindavrá nxëj[553]
I shërbej përjashta e mbrënda,
Prë lakosat[554] e lavomat[555]
Kish di lote[556] ka të njomat,
Me xhufit[557] një simpati
Të diallosurë më kish

Prë dhëmbimet[558] barku i rrij
T'i shëroj, rëmiedhi ng' ish
Tet o dhjet xhufitata[559]
E qëronej mir zorrata[560].

O fortuna o perëndia
Çë me i ndihn mir i vate
Kudo vuri duar, jatria.
Ashtu ngrëjti një ndonate[561]

547) *urtëri:* urtësi;
548) *kartúcaz:* copa letre;
549) *riceta:* receta;
550) *bëleta:* bleta;
551) *bar alloi:* një lloj bari;
552) *jodurin* (it.) aromën, erën;
553) *kudo qindavrá nxëj:* ku gjente të çmendur;
554) *lakosat;* gërvishtjet, të prerat;
555) *lavomat:* plagët;
556) *lote:* pikë, pikatore;
557) *xhufit:* klizmë;
558) *dhëmbimet:* dhembje;
559) *xhufitata:* klizma;
560) *zorrata:* zorra;
561) *ndonate:* zë, famë, namë;

Aq të gjer sa dica
Than se ngjallij me ata

Katandin mpero kurraj
Ngë e harroj, e ndënteres[562]
Mirrej qindin e mijën; andaj
U bugat, e kish turres[563]
Ndë gjith motet. Tërë t'armuar
Kish të veshurën e shtruar
Me të lier, dersinj e val
Aq, sa së jipij mirudhir[564]
Kur çë rrij njeriu në tal[565].

Fjëj mpero si fjë një lir[566]
Prë dhjet or ngadita, e rroj
Aq sa njerëzit i harroj
Së defç të martohej, e spovisi[567];
Pa të bëj mëngu dhiatë[568]!
Një gjirit[569] si miza lisi.

U rrjodhtin[570] e prë shtat
Bëjin[571], kuj të i ngitij[572] më
Nga të lënurat gjë gjë
Po sa monu[573] e vun ndë varr
Mir të xheshur, si një gur

Lumi, dia si qen ndë xharrë[574]
Me untir, o ndënjë lëkurë
Me ca mish u zu, e bënë
Një jushtri[575] çë së ka të thënë

562) *ndënteres:* interes;
563) *turres:* para, të holla;
564) *mirudhir:* erë e mirë;
565) *në tal:* cfër, pranë;
566) *lirë:* gjer;
567) *spovisi:* ngordhi, cofi;
568) *dhiatë:* testament;
569) *gjirit:* gjinitë, të afërmit;
570) *u rrjodhtin:* u mblodhën;
571) *prë shtat bëjin:* bënin zhurmë (frz.);
572) *te i ngitij:* t'u takonte;
573) *sa monu:* atë moment, sapo;
574) *ndë xharrë:* enë ku vihet yndyra e derrit;
575) *jushtri:* grindje, luftë;

Scanned with CamScanner

Scanned with CamScanner

Zun të hajin e të pijin
Mbë ato petka[576] të gadhniera[577]
Pa shërbier, e të dëthijin
Xhuta grofçi[578] e shumë të tjera
Guste, njera çë qëndruan
Pishkalaq[579] e u turpëruan!

Disjin urit, e njeri
Nëng i ndëj[580], të hajin gjë:
I ngudhirjin[581] pa lipisi
E i shajin keq e më
Aq, sa diqtin te disparnë[582]
ngrënur morrashi e të danarmë[583]!

Njerëzit thojin: pa shurbier
Së mund të hahet me sapur[584]
Buka: e gruaja çë së tier
Mëngu veshet. Sa pa kur
Neve arrën[585], ashtu na vete
E qëndronjëmi si të shkrete.

VOBËKTARI[586] I MIR

Nga një katund në njetër vate
Të gjëllij, një burr i mir.
Pati gjellën shumë të gjatë
E shërbeu sembre me hir
Me këdo vej e lej kutjend[587]
E je lipejin kudo vej

576) *petka:* toka, ara;
577) *të ngadhnjiera:* të fituara;
578) *xhuta grofçi:* ?
579) *pishkalash:* lakuriq;
580) *nëng i ndëj:* nuk i shtrinte;
581) *i ngudhjirijin:* trajtonin keq;
582) *të disparnë:* të dëshpëruar;
583) *të danarme:* të dënuar;
584) *me sapur:* (it.) me shije, me ëndje;
585) *arrën:* arrin, vjen;
586) *vobëktari:* i varfri;
587) *kutjend:* (it.) i kënaqur;

Posa rroj kurraj u pa
I mëritur me njeri
Ng'u përzie me burra o gra.
O me tjetra kondra u nxi
Çë turpëronjin, e me hje
Sembre qeshij pjot hare

Ndë sëmunda nëng rëkoi
Lastimisej[588] e nxirrepsej[589]
Kundër qielit, o mallkoj
I pëlqej e shum harepsej[590]
Me gjitonët, kur ndë mirë
Trashëgojin të dulirë[591],

Pak o fare pinej verë;
Haj sa duhej të gjëllij.
Gjë njeriu së ngau njëherë
Kurtën[592] andaj ngë e dij
Ndose ish, e pak fjalë
Thoj, e të ëmbla si mjalë.
Jip vëli[593] të dreqa shumë

Kuj ja lipij e vërtetnë
Sembre thoj: mëngu ndë gjumë
Andërrij të bëj dëm o penë
Ndo njeriu; ndose shërbej
Çë ndë menat te qisha vej.

E mënoi njera çë dielli
Mirrij udhë nga perëndima
Kjo gjellë ashtu e qelli
Prë ndë apa e prë ndë brima,
Ndë të rëndët pjakëri
.....si (Mungon varga)

588) *lastimisej:* lëvizte;
589) *nxirrepsej:* grindej;
590) *harepsej:* gëzohej;
591) *te dulirë:* të dëlirë, të pastër;
592) *kurten:* gjykatën, gjyqin;
593) *vëli:* këshilla, udhëzime;
594) *limozën:* lëmoshën;

Scanned with CamScanner

Bërë i vebër më së mundij
Të shërbej, e kish të gjëllij
Me limozën[594]; moj së tundij
Se me penë kurmin e tij,
Vej tue lipur ndato shpi
E ja jipëjin me dhuani[595].

Sa kërkoj; ai mpero
Më së lipsej prë një ditë
Nënk i lipij, e kjo
Bëmë u xu, e nkanjë prit
Herën e tij, e nëng mangoi
Se të jipij sa kërkoi.

Ndo me nxërr e me diri[596]
E përzëjin ndonjëherë
(E nk e bëj segrel njeri)
Së hejmohej pjaku i mjerë;
Moj me gaz e pa rëkuar
Gjetkë vënej tue bekuar
Ndose piejin se çë kish
Nunk e thoj kuraj e vet

I përgjigjej se kur ish
Trim shëndosh e i ri ndë jetë
Thom se bëri ndonjë fëtesë
E nani je qaj e besë
Kish të madhe te perëndia
Ja ndëlij e prësandaj[597]
I dërgonej metania[598]
Posi lule çë kurraj
.....sa mbështon (mungon)

Një mbëkat kuj e kujton
Kur ndë diell e kur ndë hje
Porsi lipsej o hjesohej[599]

595) *me dhuani:* me vullnet, me qejf;
596) *diri:* inat, zëmërim;
597) *prësandaj:* ndërkaq;
598) *metania:* mrekullia;
599) *hjiesoj:* rrinte në hije;

Djelëmit, e vejin re
E nganjë i afrohej;
E të falëjin e për nënë
Gjithë i ujçin tuke thënë:
Se ti lal megallos[600]
Nëng na thue ndonjë përrallë?

Ndonjë stori o ndonjë këllos[601]
Çë pëndiksën[602], çë bën valle
Me të sajat poloqidhe[603]
Çë kanë t'arrin në cimbidhe[604]
Plaku qefçij[605] ëmbëlsisht

E i thoj: arrut nani
Se të bëni haidhisht[606]
Ca rrëmurë e bredhmja ti?
Ndose duani të ju thom
Gjë, kin rrin qet e njom
Dhia si valt ndë ranxhele,
Si ndë zemër rri sperënxa
E si hit rri ndë koçele[607]
Rrimi na, ndose rrëmënxa
Ti na thua nga ato çë di
Se na bëjn tri ëmbëlsi.

Dini ju se çë pësoi
Një djali ndë një mot
Pak i lart, se së vështroi?
Mirë të jëmën? Jore Zot
.....ku ai (mungon)

Ju e rrëfienj këtu nani.
"Jëma i thoj: mos ec me Nçikun[608]
Se të liga të porosin,

600) *megallos:* (gr.) i madh;
601) *këllos:* kllukë, klloçkë;
602) *pëndiksën:* tund krahët;
603) *poloqidhe:* zog pule;
604) *cimbidhe:* me sqep;
605) *qefçij:* qeshte;
606) *hajdhisht:* së mbari;
607) *koçele:* vatër;
608) *Nçikun:* zbunim, i Françeskun;

Scanned with CamScanner

Dardhën, kumbullën e fikun
Mos ja ngit njeriu. Ndë hin
Ndë një kopsh se të shkoç
Pemët mëngu ke t'i ruaç.
Me Koluçin çë pi verë

Mosnjë mot ti u përziej:
Se të veç me të di herë
Ndë katoqe, mos më piej
Çë mund vinj të keqi tij
Më se nëng i arruri atij
Me këto djejm çë mallkonjin
E së dinë të thonë një fjalë

Dreqëzisht[609], e mos turpëronjin
Posa shohën si me valj
I përzier me pjëh e hi
Zbukurohet një stoli,

Ti biri im mos u bashko
Se këta janë si pësora[610]
Cila ngjitet dash o jo
Kur më e të tiren ngrohet dora

Të mëdhenjve më se ti
Mos përgjigj me nxirr, e di
Thoj këta e aq të tjera
Fjalë më të mira noiteshia[611]
Jëmë të birit, ndë gjithë hera
Moj ai si gjegjet mosha
.....rrij (mungon)

Vet me tru ndë bëgatëri[612]
Gjegjij e ng'i vënej re:
More bëri shtrembërisht
Sa i porositi ajo me hje

609) *dreqëzisht:* drejt;
610) *pësora:* fatkeqësi;
611) *noiteshia:* zonjë bujare, zonjë shtëpie;
612) *bëgatëri:* pasuri, begati;

Shumë të mir e dashurisht.
Moj pastana ç'i pësoj

Kur të jëmën së ndikuroi?
Thanë ata: atij ganjun?
Ndjeku plaku. Rrukulisi
Pa u qëndruar kurraj gjikund!
Ka një vix ndë njetër udhisi,
E nga mali vate ra
Ndë një gropë çë sjetë së ka[613]

Keq u nxi, e lig u bë
Zëhej, dehej e mallkoj
Haj e pij, e ndo së kish gjë
Tjerëve mirrij e kalloj
Mbë serpos u bë banit[614]
E duroj Pushtier[615] një vit
Vritij njerëzit e i xheshij

Sido të ishin, të bëgetë
O të nëmur, vrit e qeshij:

E harepsej se ai vetë
Gjith katundi bën e dridhej;
E njeri së guzoi të i hidhej,
Moj ç'i bëtitin ndë serpos?
Thojin djejmit të hejmuar.
Kado bëme ka një sos
.....këmbe e duar (mungon)
.....e zunë (mungon)

Ndë filiaqi e vunë.
Njohtin ligjen e nji- njé
E dërguan të disij vjerrë.
Mbiatu e vuartin, e atje
Lanë se të ish ka zogjet i shqerrë.
Gjakun qent i lipitëtin

613) *sjetë së ka:* e pafund;
614) *banit:* (it.) bandit;
615) *Pushtijer:* lokalitet në brigjet e Qanës (Çerzeto);

Scanned with CamScanner

Prana eshtrat i përpitëtin
Bjerrafati! Thirrtin gjith

Të tromaksur djejmit
Qelli dëmin dhia në vith
Çëkur leu e hejmit
Ndë rëmënxat çë na the
Më kjo na bëri tre!?

Ju porsiftit e ju bëtë
Si ju duan prindit e tëjë
Mir zakonin, e ju lëtë
Prë lipisi fanëmiri tëj
Mos të bini ku ra ki
Çë rrëfiejta, fat i zi.

KARROQARI[616]

Ish një prift i holl e i gjatë
Ndë një katund e acarun[617]
Çë së lëj ndonjë menatë
Të thoj meshën ku gjikun.
E sa më mblidhij turres
Thoj se s'kish, e jipij besë
Kish të vjetër një sutan[618]
..... të shqerrë (mungon)
.....mbënjanë (mungon)

Sikur t'ish ndë ku je vjerrë.
Kish të arnuara ca këpucë
E të trasha sa një vucë[619],
Ngë mënoi mpero ndë shpi
Vet një kredë[620], e vej e vij
Tuke sjellur dhe e hi

616) *karroqari:* kopraci, dorështrënguari;
617) *avarum:* dorëngushtë, dorështrënguar;
618) *sutani:* (it.) rrobë, fund;
619) *vucë:* enë për të mbajtur ujë, bucelë;
620) *kredë:* çast, moment, herë;

Si bëljeta. Nëng pushtij
Mos të grisij vetëhenë.
E haj buk vetëm si qen!

Kish një shtrat sa një paidhe[621]
Të pështruar me një pajacë[622]
Gjith e arnuar, si një stafidhe[623]
Zezullore, e gjer di brac[624]
Tri je gjatë; e ndën një thes
Çë vlej mosnjë shërbesë.

E për aq ati pushoi
Posi guri ndë putril

Të një ronxi[625]. Ngë i qëlloi
Shumë mpero, se mbanej ndë il[626]
Ca muriza shpojtare[627]
Çë nk e lëjin fare- fare
Kun kujtuame çë ndë tru
Sembre i vejin se njeri
Mund i vidhij, e ndë gju
(Çë prëhapej prë ndë shpi)
Mbaj të lidhurëz një tërkuzë;
E ca fosfoj[628] për ndë buzë
E bërë nëgoxë[629] stiende[630]
.....të kish (mungojnë)
.....gjith vente.

Me këdo gjendej, kudo ish
Me këdo gjendej, kudo ish
Fjit nga ato, e sembre thoj:
Se të mira ning i çoj

621) *një paidhe:* një çast, një minutë;
622) *pojacë:* mbulesë;
623) *stafidhe:* rrush i thatë;
624) *brac:* bërryl;
625) *ndë putril të një ronxi:* në fund të një pellgu;
626) *ndë il:* në ije;
627) *shpojtare:* e mprehtë, që shpon;
628) *fostoj:?*
629) *nëgoxe:* (it.) treg, dyqan;
630) *stiende:* (it.) sakrifica;

Scanned with CamScanner

Posi lusij; e ndë qëngje[631]
Ng' i rëndojin e ndë leshe
Si të tjerëve. Ndonjë skamënqe[632]
Vet i bëjin e ndë deshe
S'kish furtunë. Pra ndë djath
Bënej aq sa haj me bath.
Thoj ai. Po shtrembërisht
Vej shërbesi, e vjetër çerë
Kish, se ai buftoi me bisht
Burrin çë ka vithen e gjerë.
Vate në qishë një dit t'e thoj
Meshën, e delezit pensoi.
Sakristani kur e pa
E të fali, pa mëri
Ng' i përgjigjij, e i tha: ç'ka
Imi dash çë keq më rri?
Thom se ka ethen të verdhe
E ndë krie të boçka herdhe[633]
I përgjigji Sakristani.
Prifti nëng e vuri re
Më se poçes[634] vë tiani[635]
Ndo të zienjën bashk: le le
Vate u vesh, e ndë lartar[636]
Rrij, si thoj meshën e parë.
Një thërrimes mbarëvalisej[637]
.....thoj (mungon)
.....e nisej (mungon)

Pometa prirë të e thoj
Mos së mundi me atë penë
Të mblidh trutë mbë vetëhenë
Ëndërri thom se të kish vatur

631) *qengje:* qengja;
632) *skamënqe:* shtëllungë;
633) *boçka herdhë:* qepë e egër;
634) *poçes:* poçe për fasulet;
635) *tiani:* tigani
636) *lartar:* (it.) altar;
637) *mbarëvalisej:* pengohej në të folur;

Ndënjë markat të shitij gjë
E tue shitur e tue ngjatur
Shumë, kundrartin më e më
Më u harrua çë bëj, ku ish
Ndo Pushtier, ndë shpi, ndë qish.
Për të marrurin adet
Meshën thoj çë kish ndë mund:
Kur u pruar të thonej; vet
Parkalesën ndë këtë vend
O vëllezër; i tha ai:
Imi djath ka di karri[638]
Ndokush të e paguan ti gjenë
Sakristani iu përgjegj:
Një nigoc tri mir t'i bën!?
Gjindja çë ish meshën të gjegj.
Një leshuarë një gaz i gjatë,
E më bën një rrëmuratë?
Prifti u adunar e nje
Me tri fjalë meshë mbaroi.
Çë ne ahierna më së qe
Karroqar, pse ndigoi,
Se ndë tjerët ki vix më nxinë
Djeg e grisën si kaminë!
Ndose arruret ka një herë
Një mirakull posi ki
.....gjer
(mungojnë dy rreshta)
.....
.....
Moj pse vixet guarçojnë[639]
Zotruan e zotëronjinë.

VIDHJUZIA[640]

Qe një grua një herë e gjallë
Cila hëngri e piu si ani

638) *karri:* monedhë;
639) *guarçojnë:* verbojnë, i nxjerrin sytë;
640) *vidhjuzia:* zilia;

Hanë e pinë, e ndjenjin mallë
Gjith sa janë mbi dhe; moj ki
Ngë është sherbes vërteta i ri
Cili ju bënj cjudhi[641]
Moj cjudhi pa ëh[642] e jo
Mund të ndieni kur çë xëni
Se kush qe, çë bëri ajo:
Hapni sit andaj e vëni
Re në gjasmen[643] çë ju bëni
Ndo të e marr si qe t'arrënj,
Kriet e kish si kunkuloth[644].

Ballt i zi e vetullat
Me ca qime si qemboth[645]
Të golasme[646] tëmbëlat
Vesht e gjata e mallëzuame[647]
Cimërat mbë një të shtuame.
Kurmin kish të likshtullor
Misht i trashë, e pak të zi
Kish të gjataz atë lor[648],
E si maçja ruan një mi
Ruaj kur fritij e përdridhij
Qafën e gjatë e faqe mblidhij
.....zënë
.....
(mungojnë)
Dhia si dhia vej tuke bëmë
Ndo të ecij e të flit
Lia[649] çë pati gropa gropa
Çerën i bëri e copa copa
Me këdo piqej vet një her.

---

641) cjudhi: ?
642) ëh: po, pa ëh e jo: frz. pa po pa jo/ pa një pa dy;
643) në gjasmen: në ngjashmërinë, në krahasim;
644) kunkuloth: kungull;
645) si qemboth: ?
646) të golasme: të futura përbrenda;
647) mallëzuame: ?
648) lor: krah, llërë;
649) lia: lia.

Università degli Studi della Calabria - Biblioteca di Area Umanistica
BIB. AREA UMAN.
N.I. 106707
Data 13.07.01

Scanned with CamScanner